

Maqedonia  
thyen rekordin  
e radhës, e para  
për konsumin  
e cigares

Fq.3



RENDITJA E  
WEBOMETRICS  
UKM e para,  
UEJL e treta dhe  
UT e pesta

Fq.3



Test i  
Chur-  
chillit  
Forum

Fq.11



# Koha

www.koha.mk



KOHA për  
enigmë

Fq.12-15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3444 · e shtunë/e diel, 25-26 gusht 2018

19°C | 29°C

15 DEN

## FORUM

Etnocentrizmi  
i Mbrëmjeve  
Poetike të  
Strugës



Sa herë që vijnë Mbrëmjet Strugane të Poezisë, një temë nuk ndryshon: mos përdorimi i gjuhës shqipe. Ndryshojnë fituesit e Kurorës së Artë, drejtorët, anëtarët e këshillit, por jo dhe të ndërrojë praktika e mospërfilljes së gjuhës shqipe, të cilën në këtë qytet e flasin më shumë se gjysma e banorëve. Pra, assesi të fitojë urtësia e zemërgjerësia e frymës poetike, e cila nuk njihet kufi. Sepse ata që i organizojnë këto mbrëmje, kanë një dioptri, dhe vazhdojnë t'i shikojnë gjërat përmes të njëjtës...

Fq.10

## RAJON

Në Serbi  
flitet vetëm  
për ndarjen  
e Kosovës

Fq.16

## GLOBI

Rumania,  
përtej asaj  
që duket

Fq.17



## ANALISTËT PRESIN SUKSES MË 30 SHTATOR

# REFERENDUMI, PËR FITON EDHE RAJONI



Publicistë dhe ekspertë nga Maqedonia, Kosova dhe Shqipëria vlerësojnë se një Eeferendum i suksesshëm në Maqedoni dhe anëtarësimi i saj në NATO, do të thotë më shumë siguri në rajon, më shumë zhvillim ekonomik dhe demokraci institucional në shtetet ku jetojnë shqiptarët dhe njëkohësisht izolim të forcave radikale në Serbi

Fq.4

## Rritja prej 5% e pagave, s'e ndalon ikjen e mjekëve

Shkup, 24 gusht - Punonjësit e institucioneve publike shëndetësore nga shtatori do të marrin paga më të larta prej 5 për qind. Bazuar në të dhënat e Odës së punonjësve shëndetësorë, kjo masë do të përfshijë rreth 10 mijë persona, të cilët do të kenë një rritje që do të sillt nga 1000 denarë apo 15 euro e deri në 3000 mijë denarë apo 50 euro. Me këtë vendim, sipas Qeverisë, veç tjerash synohet të luftohet edhe duku-

ria e largimit të mjekëve nga Maqedonia për shkak të mungesës së vendeve të punës, pagave të ulëta që sillen nga 300 deri në 600 euro, por edhe kushteve tjera për punë. "Me këtë masë, Qeveria edhe njëherë tregon përkushtimin e saj për mbajtjen e punonjësve mjekësorë në institucionet publike shëndetësore në vend. Vlerësojmë se me rritjen e kompensimit për punën jashtë orarit të rregullt..."

Fq.7





## EDITORIAL

# VETERANËT PA HISTORI BETEJASH



Emin AZEMI

Ata që ndihmuan në çlirimin e Kosovës e kanë të qartë se ajo do të vazhdonte të ngelte e robëruar nën thundrën serbe po të varej fati i saj prej veteranëve që sot për një pagë modeste janë në gjendje të falsifikojnë të kaluarën e tyre. Kosova ka të ardhme tjetër dhe ajo nuk varet nga falsifikatorët e historisë së saj

Një luftë mund të jetë apo jo e suksesshme, varësisht nga menaxhimi i pasluftës. Është e njohur përvoja e deformimeve që ka pasuar periudhën e luftës, kurse bartësit e këtyre deformimeve e kishin përdorur luftën si "kartë bankomati". Por, në anën tjetër, luftëtarët e vërtetë asnjëherë nuk e keqpërdorën luftën. Ata madje i ke më të pazëshmit dhe shpesh të marginalizuar nga shoqëria.

Tash së fundi Prokuroria Speciale e Kosovës ka konfirmuar se pas hetimeve, që do të zhvillohen lidhur me rastin e njohur si 'lista e veteranëve të UÇK-së', do të propozohet një aktakuzë, e cila do t'i dërgohet gjykatës që veteranëve "mashtrues" t'u ndërpriten pagat.

Hetimet e reja pasojnë një proces të lënë në gjysmë nga ish-prokurori Elez Blakaj, i cili dha dorëheqje me arsyetimin se mbi të po bëhen presione. Institucionet e drejtësisë ende nuk janë deklaruar prerazi se çka do të ndodhë me ata persona të cilët kanë marrë para nga buxheti në mënyrë të kundërligjshme.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për shtatë muajt e parë të këtij viti për këtë kategori janë ndarë më shumë se 44 milionë euro. Sipas dokumenteve të kësaj ministrie vërehet se për çdo muaj është rritur numri i përfituesve, rrjedhimisht edhe shuma e ndarë e mjeteve financiare.

Prokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka thënë në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, se numri i përfituesve të jashtëligjshëm nga kjo kategori, mund të jetë deri në 19 mijë veta.

Për çfarë menaxhimi të pasluftës mund të flasim në Kosovë? A është normale për një pjesë të shoqërisë që të legjitimohet se spekulative me tema të ndjeshme, siç është sakrifica për liri. Kujt i shërbejnë këta "veteranë të rrejshëm" dhe kënd donë ata ta mashtrorjnë? A kanë ata bashkëlufëtarë dhe si quhen betejat që ata bënë në frontet e luftës me forcat serbe? Si quhen komandantët e tyre dhe në cilën datë u inkuadruan në luftë?

Janë këto jo thjeshtë pyetje, por edhe alarm për këtë soj veteranësh të kontrabanduar që po duan me çdo kush të na imponohen si faktorë të rëndësishëm. Një Zot e di sa përfitime kanë kullotur ata në emër të këtij kontrabandimi dhe kush e di sa fëmijë të tyre kanë gëzuar privilegje për të qenë në lista prioritare nëpër universitete e institucione të ndryshme.

Dëmi nuk është vetëm financiar. Më i madh është dëmi moral. Një vetëdije e tillë e deformuar që kontrabandon figura të paqena ka si nusprodukt shtresën më të pandërgjegjshme të shoqërisë. Kjo shtresë ka punuar me të madhe që imazhin e popullit të vet ta paraqes në dritën më të errët. Sikur të dominonte kjo vetëdije, Kosova që moti ishte harruar nga aleatët Perëndimorë. Mirëpo ata që ndihmuan në çlirimin e Kosovës e kanë të qartë se ajo do të vazhdonte të ngelte e robëruar nën thundrën serbe po të varej fati i saj prej veteranëve që sot për një pagë modeste janë në gjendje të falsifikojnë të kaluarën e tyre.

Kosova ka të ardhme tjetër dhe ajo nuk varet nga falsifikatorët e historisë së saj.

## MOLLA E NDALUAR E ELEZ BLAKAJT

"Ekzistojnë dy qasje ndaj prokurorit Elez Blakaj, atij që nxori se nga lista e përgjithshme e veteranëve të UÇK-së e që përfitojnë pension nga buxheti i Kosovës, së paku 19 mijë janë aty në premisa mashtruese, pra janë falsifikatorë.

Njëra qasje është që ky pretendim i prokurorit të vërtetohet në proces gjyqësor. Një proces i këtillë do të ballafaqonte pohimin fillestar të komandantit të fundit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Agim Çeku, dërguar organizatave të OKB-së në qershor të vitit 1999 se duhet demobilizuar 12 mijë ushtarë të UÇK-së me pohimin përfundimtar të Agim Çekut, kryetarit të Komisionit për evidencimin e veteranëve të UÇK-së, se numri i veteranëve kishte kaluar 50-mijëshin dhe ishte nisur për në shifrën 60 mijë.

jetra qasje është që të kërkohet momenti historik, ora dhe data, kur në njërin prej pemishteve të Kovragës së Istogut ai që do të bëhet prokuror, nxënësi Elez Blakaj të ketë vjedhur ndonjë mollë. Prej dy qasjeve të mundshme Kosova zyrtare ka zgjedhur të dytën. Pra, për udhëheqjen e Kosovës nuk është problem se numri i veteranëve të luftës që përfitojnë pensione është pesëfishuar. Problem themelor i Kosovës është shndërruar Elez Blakaj. Ndonëse ende nuk dihet nëse ka vjedhur a jo, dikur në fëmijërinë e tij të hershme, ai tashmë është vlerësuar zyrtarisht të jetë 'pishpirik', 'hajni i pulav' dhe 'frikacak'.

Nëse Elez Blakaj mund ta ketë marrë një mollë me leje a pa leje nuk është më me rëndësi. Ai është quajtur 'pishpirik', 'hajni i pulav' nga kryeministri i vendit dhe 'frikacak' nga kryetari i Kuvendit. Që të dytë janë njëkohësisht kryetarët e partive që sajojnë në masë të madhe koalicionin në pushtet, pra, kur ata i thonë një prokurori se është hajni dhe frikacak komunikimi që bëhet nuk është mes emrave të përveçëm, por mes institucioneve. Dhe, meqë është kështu, i bie që prokurori i Kosovës i nënshtrohet vlerësimit personal të bartësve të pushtetit, jo të institucioneve...", shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti Veton Surroi.

## NDAJ MOS U HABISNI...

"Ndikim i fortë dhe i përhershëm i historiografisë sllave dhe i lobit sllav në Shqipëri është përdorimi në tekstet shqiptare, që nga 1944 e deri në ditët tona, i termit eufemistik 'dyndjet sllave' në Ballkan, në një kohë që kemi të bëjmë me fenomenin klasik të pushtimit sllav të territoreve iliro-shqiptare. Shkenca zyrtare shqiptare ka harruar me qëllim pushtimet e përgjakshme serbe si në Kosovë, ashtu dhe pushtimin serb në Shqipërinë e Veriut, që zgjati afro dhjetë vjet pas shpalljes së pavarësisë. Ndjaj mos u habitni, ndonëse është për të ulëritur, kur sot idiotët e dobishëm të Serbisë në Tiranë shpallin se midis shqiptarëve dhe serbëve nuk ka pasur luftëra asnjëherë. Ndjaj mos u habitni, ndonëse është për të ulëritur, kur del një kryetar i një partie parlamentare serbe dhe deputet serb dhe deklaron në gushtin e 2018 se Serbia do ta pushtojë Shqipërinë deri në Durrës, dhe nuk reagon asnjë zyrë shtetërore e Shqipërisë. Kishte të drejtë Fan Noli i madh kur u drejtohej shqiptarëve me shprehjen lapidare 'skllëvër bij skllëvërish, liri s'doni', shkruan në profilin e tij në FB, diplomati shqiptar Shaban Murati.

## MEDIACitate

## ZGJIDHJA PËR KOSOVËN DO TË DISKUTOHET EDHE NË KS TË OKB

Zgjidhja përfundimtare për Kosovën, nëse arrihet midis Beogradit e Prishtinës, do të duhej të diskutohej edhe në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Kështu shkruan e përditshmja e Beogradit "Večernje novosti", e cila thirret në burime të saj nga qarqe diplomatike. Në këtë mënyrë kjo temë rikthehet nën mbikëqyrjen e organizatës botërore, nga e cila u hoq përmes një rezolute më 2010, që e kishin parashtruar autoritetet e atëhershme serbe, duke e futur praktikisht në duart e Bashkimit Europian, si ndërmjetës në dialogun midis dy palëve, shkruan kjo gazetë. "Novosti", ky rend hapash krijon hapësirë që Beogradi pozicionin e vet strategjik ta ndërtojë me mbështetjen e Moskës e të Pekinit, ndërsa, siç pritet, në diskutimin eventual para qeverisë botërore, rol vendimtar gjithsesi do të luajnë Rusia dhe SHBA. Këto dy fuqi, siç paska marrë vesh "Novosti", do të duhej të bisedonin për modalitetet e zgjidhjes së nyjës së ngatërruar të Kosovës, por të dihet se me Moskën ekziston një marrëveshje e fortë që ajo të mbështesë propozimin që do ta paraqesim (e ka fjalën për Serbinë, sqarim ynë). Kjo gazetë citon ambasadorin e dikurshëm Millovan Bozhinoviç, sipas të cilit do të ishte politikisht e logjikshme, nëse arrihet marrëveshja, që ajo t'i prezantohet Këshillit të Sigurimit dhe nga ky këndvështrim ai e sheh rolin e forcuar në kohë të fundit të Rusisë në këtë proces. "Para Këshillit të Sigurimit mund të arrijë vetëm dokumenti i dakordësuar mes anëtarëve të këtij organi dhe jo si propozim të cilin Rusia ose SHBA do të çonin gishtat kundër. Nëse do të jetë opsion i pranuar nga të gjithë, ai atëherë do të ndërliqej me Rezolutën 1244 dhe që në këtë proces të vihet pika", vlerëson ky ish-diplomat, shkruan "Novosti".

(Novosti, 24 gusht)

## NËSE NUK E KENI DITUR...

## ÇFARË KANË QENË HANET?

Hanet kanë qenë ndërtime të ngritura gjatë rrugëve të komunikacionit ose në qendrat e banuara për t'u shërbyer udhëtarëve e karvanëve me kafshë. Përbëheshin nga mjediset e fjetjes dhe të shërbimeve. Pranë tyre ngriheshin punishte për nevojat e kafshëve. Në qytete, zakonisht ishin pranë pazareve.

Planimetria më karakteristike e haneve ishte një oborr i brendshëm me ndërtesa dykatëshe përreth. Kati përdhej përdorej për stallat e depo ndërsa në ballin nga rruga, për dyqane. Në katin e sipërm ishin dhomat e fjetjes, me një galeri të hapur ndaj oborrit. Pajisjet e dhomave të haneve ishin tepër të varfra.



Në nivel vjetor, harxhimet e duhanxhinjve arrijnë në 16.065.000.000 denarë, e barabartë kjo me 4.31 për qind e Bruto Prodhimit Vendor të Maqedonisë. Rritja e numrit të duhanxhinjve, siç shkruan tobaccoatlas.org, po rrit edhe numrin e harxhimeve mjekësore të shtetit

Koha Evis HALILI

Shkup, 24 gusht - Në Ballkanin Perëndimor, konsumin më të lartë të cigareve, ku një person mbi 16 vjeç (41.5 për qind) pi mesatarisht në një vit mbi 2000 cigare, është Maqedonia dhe në vend të dytë Shqipëria. Kështu thuhet në hulumtimin e publikuar nga tobaccoatlas.org, sipas të cilës, mbi 1000 fëmijë nga moshë 10 deri në 14 vjeç (1.41 për qind) janë konsumues të rregullt të duhanit, ndërsa mbi 4000 vdekje në nivel vjetor, shkaktohen nga dëmet që sjell duhanpirja. Në nivel vjetor, harxhimet e duhanxhinjve arrijnë në 16.065.000.000 denarë, e barabartë kjo me 4.31 për qind e Bruto Prodhimit Vendor të Maqedonisë. Rritja e numrit të duhanxhinjve, siç shkruan tobaccoatlas.org, po rrit edhe numrin e harxhimeve mjekësore të shtetit.

## VENDET ME KONSUMIN MË TË LARTË NË BOTË

Vendi me konsumin më të lartë të cigares në botë është Andorra, ku sipas të dhënave konsumi i cigares për popullsinë mbi 16 vjeç në 2016 ishte 6398 cigare, pasuar nga Luksemburgu me një konsum prej 6330 cigare. Më pas me një diferencë të konsiderueshme, renditet Bjellorusia ku konsumi i cigareve për frymë sipas të dhënave të tobaccoatlas.org llogaritet 2911 cigare. Ndërsa vendet afrikane dhe një pjesë e vendeve të Amerikës Latine janë ato që kanë konsumin më të ulët, sikurse vërehet edhe nga harta.

## TË DHËNA ALARMUESE TË TOBACCOATLAS.ORG

# MAQEDONIA THYEN REKORDIN E RADHËS, E PARA PËR KONSUMIN E CIGARES

"Megjithëse viteve të fundit Maqedonia ka bërë progres për kontrollin e duhanit, qytetarët e këtij vendi vazhdojnë të vdesin si shkak i sëmundjeve që po fitohet nga duhanpirja. Shteti mund dhe duhet të bëjë edhe më shumë që të parandalojë duhanpirjen tek të miturit, numri i të cilëve si konsumues po shtohet ditë e më shumë", shkruan tobaccoatlas.org.

Në 2016, tobaccoatlas.org tregon se Maqedonia prodhoi 27.578

## NË ÇFARË MOSHE FËMIJËT E FILLOJNË KONSUMIN E CIGARES

Cigarja mbetet shkaktari i vdekjes së rreth 6 milionë njerëzve në botë çdo vit, sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Për shumicën, duhani fillon në shkollën e mesme. Mirëpo, në çfarë moshe fillon saktë konsumimi i tij në përgjithësi? Në Amerikë, si dhe në pjesën më të madhe të Evropës, studimet tregojnë se

ndezja e parë e cigares ndodh në mes të moshës 15-16 vjeçare, raporton tobaccoatlas.org. Në SHBA 15.3 ishte moshë mesatare kur fillon konsumimi i cigares, përderisa në vendet evropiane cigarja fillohet rreth moshës 16 vjeçare të djemtë, kurse përfaqësisht nga moshë 15 vjeçare vajzat fillojnë duhanin.

ton duhan, apo 1.48 për qind e prodhimit të agrikulturor në vend. Shndërruar në cigare, vetëm në Maqedoni ishin prodhuar 4.120.000.000. Sipas tobaccoatlas.org konsumin më të ulët të cigares në rajon e ka Mali i Zi me 1101 cigare. Më pas renditet Bosnje dhe Hercegovina, ku konsumi i cigares është 1767, e ndjekur nga Serbia me 1899 cigare. Shqipëria, e cila në nivel rajonal renditet e dyta, ndërsa e gjashta në botë për konsum të lartë të cigareve për frymë, ka gjithashtu të dhëna të tmerrshme.

Sipas tobaccoatlas.org, konsumi i cigareve te shqiptarët mbi 16 vjeç ishte 2492 cigare për person për vitin 2016, duke u renditur kështu ndër vendet me konsumin më të lartë në botë.

Në ndërkohë, tobaccoatlas.org raporton se në të gjithë botën është përllogaritur se janë konsumuar rreth 5.7 trilionë cigare. Edhe pse konsumi ka rënë lehtë në vitet e fundit, ecuria e kësaj industrie është e pasigurt. Pavarësisht angazhimit të industrisë së duhanit për të pasur një shoqëri që consu-

mon sa më pak atë, në disa prej shteteve të botës vijon të bëhen fushata marketingu, ndërsa rënia e konsumit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Australi, Brazil, lidhet me implementimin e ligjeve të forta për të reduktuar konsumin e tij.

Sipas analizës së kryer nga tobaccoatlas.org, konsumi i cigareve parashikohet me rritje në shumë prej vendeve me të ardhura të ulëta dhe të mesme si pasojë e zhvillimeve dinamike ekonomike dhe rritjes së vazhdueshme të popullsisë.

## WEBOMETRICS PUBLIKON RENDITJEN E UNIVERSITETEVE

# UKM e para, UEJL e treta dhe UT e pesta

UEJL dhe Universiteti i Tetovës, ndryshe nga vitet e fundit, sivjet kanë shënuar ngritje në ranglistën e Webometrics. UT, nga pozita e tetë vitin e kaluar, sivjet është renditur e pesta, derisa UEJL mban vendin e tretë

Koha Remzije BILALLI

Shkup, 24 gusht - Universiteti "Kirili dhe Metodi" (UKM) në Shkup edhe sivjet është universiteti që radhitet në vendin e parë në rangimin e Qendrës publike për hulumtime Webometrics. Me 100 pikë të grumbulluara (numri i studentëve, kushtet e punës dhe suksesi i studentëve), UKM në Maqedoni është regjistruar edhe si universiteti me vendin e parë në kategorinë për kërkime shkencore. Universiteti "Goce Dellçev" në Shtip është radhitur i dyti, ndërsa Universiteti i Evropës Juglindore në vendin e tretë në rangimin e Webometrics.

UEJL dhe Universiteti i Tetovës, ndryshe nga vitet e fundit, sivjet kanë shënuar ngritje në ranglistën e Webometrics. UT, nga pozita e tetë vitin e kaluar, sivjet është renditur e pesta, derisa Universiteti Ndërkombëtar Ballkanik është ngjitur në pozitën e gjashtë. Në vendin e katërt është "Shën Klimenti i Ohrit" në Manastir, në vendin e shtatë Universiteti për Informatikë dhe Shkencë në Ohër, FON-i në vendin e tetë, Universiteti për Inxhinieri "Kirili dhe Metodi" në vendin e nëntë, ndërsa "Kolegji Amerikan" mban vendin e dhjetë.

Në fund të listës së Webometrics gjenden Akademia e Biznesit

"Smilevski", në Shkup, "Euro Kolegji" i Kumanovës, si dhe Akademia Ushtarake "Goce Dellçev".

Webometrics është ranglista më gjithëpërfshirëse e vlerësimit të institucioneve të arsimit të lartë në të cilën numri i institucioneve që vlerësohen është rreth 30 mijë. Pas rangimit katastrofal tek "Lista e Shangajit" ku universitetet e Maqedonisë nuk ishin fare në listë, në bazë të Webometrics, vlerësimet e bëra në korrik të këtij viti, UKM radhitet në vendin e 1624, ndërsa ai i Tetovës në vendin e 5642 në listën e universiteteve më të mira në botë. Nga universitet private, në vendin e 4124 radhitet Universiteti i Evropës



Juglindore.

Webometrics ka filluar të konsiderohet si një nga ranglistat më të rëndësishme botërore, sepse ndjek trendet e transformimit të arsimit të lartë me mbështetjen e teknologjisë së komunikimit e informimit. Rangimi bëhet në bazë të kritereve si njohjen e nivelit të mirë të punës shkencore të botuar, num-

rin e studentëve, si dhe përmbytjen dhe shpërndarjen e informacionit nga burimet elektronike nga institucionet përkatëse. Në të gjitha matjet ndërkombëtare të cilësisë dhe referimeve shkencore, universitetet e Maqedonisë vazhdojnë të jetë dëshpëruese dhe shumë larg cilësisë të cilën e proklamojnë.



ANALISTËT PRESIN SUKSES MË 30 SHTATOR

# REFERENDUMI NDIHMION JO VETËM SHQIPTARËT, POR EDHE RAJONIN

Publicistë dhe ekspertë nga Maqedonia, Kosova dhe Shqipëria vlerësojnë se një Eferendum i suksesshëm në Maqedoni dhe anëtarësimi i saj në NATO, do të thotë më shumë siguri në rajon, më shumë zhvillim ekonomik dhe demokraci institucionale në shtetet ku jetojnë shqiptarët dhe njëkohësisht izolim të forcave radikale në Serbi



MUSA SABEDINI

Duhet të jetë e qartë se Maqedonia pa pjesën shqiptare është gjysmake, është e vdekur. Ky fakt na jep të drejtë të kuptojmë se shqiptarët në Maqedoni kanë përgjegjësi historike që të jenë pjesë e këtij procesi të rëndësishëm dhe vendimtar. Mund të ketë zëra kritik dhe kundërshtues, por argumenti historik flet në favor të daljes në Referendum dhe vulosjes së Maqedonisë, si shtet që garanton të drejtat e shqiptarëve



ISMET RAMADANI

Shqipëria veç më është në NATO edhe Maqedonia bashkë me shqiptarët brenda saj do të jetë në NATO, ndërsa në Kosovë procesi mund të jetë më i gjatë, por aty NATO është prezente derisa të bëhet anëtare e plotë dhe kjo do të thotë shumë

cilës edhe gjendja ekonomike e sociale e shqiptarëve do të përmirësohet ndjeshëm.

## SUKSESI I REFERENDUMIT QË TË DËGJOJË SERBIA

Ish politikani Ismet Ramadani thotë se përgjigja me PO në Referendum për emrin më 30 shtator do të thotë shumë për Maqedonisë si në planin brendshëm, ashtu dhe në planin gjeostrategjik. "Mendoj se do të përshpejtohet anëtarësimi në NATO dhe rruga për në BE, gjë që pa dyshim do të ketë impakt pozitiv edhe në nivel rajonal si në aspekt të sigurisë, ashtu dhe aspekt të zhvillimit të demokracisë sidomos demokracisë institucionale", thotë Ramadani, njëherësh dhe kryetar i shoqatës "Këshilli euroatlantik i Maqedonisë". Shqipëria, shton Ramadani, veç më është në NATO edhe Maqedonia bashkë me shqiptarët brenda saj do të jetë në NATO, ndërsa në Kosovë procesi mund të jetë më i gjatë, por aty NATO është prezente derisa të bëhet anëtare e plotë dhe kjo do të thotë shumë. Për Ramadani, një Referendum i suksesshëm në Maqedoni dhe anëtarësimi i saj në NATO, veç tjerash do të ketë reflektoje pozitivisht edhe në Serbi, kur forcat radikale, siç thotë ai, do ta shihnin veten të izoluar në të gjitha anët. "Kur jemi tek Serbia, ajo është përcaktuar vetëm për në BE, por jo edhe për NATO-n. Në këtë rast, anëtarësimi i Maqedonisë nuk

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 24 gusht - Referendumi për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së emrit me Greqinë gjithnjë e më shumë po merr vëmendje ndërkombëtare, jo vetëm të mediave, por edhe të qeverive të shteteve të mëdha të Bashkimit Evropian dhe më gjerë. Kryeministria e shtetit më të fuqishëm të BE-së, Gjermanisë, Angela Merkel së fundmi përmes një bisede telefonike që pati me kryeministrin Zoran Zaev i dha mbështetje të fuqishme Marrëveshjes për emrin me Greqinë. Përveç Serbisë, që mbahet e rezervuar sa i përket Marrëveshjes me Greqinë, e cila me gjasa reale që do të sjell anëtarësim të plotë në NATO nëse kalon në Referendum, të gjitha vendet fqinje dhe vendet tjera në rajon i kanë dhënë mbështetje marrëveshjes për emrin. Kjo dhe nga fakti se me anëtarësimin eventual të Maqedonisë në NATO, shpresohet ti mbyllet kanalet e përzjerjes dhe ndikimit të Rusisë në Ballkan. Por mbi të gjitha, kur Shqipëria është veç më në NATO, ky Referendum po pritët me interes edhe tek shqiptarët në të tre shtetet - Kosovë Shqipëri dhe në vetë Maqedoninë. Por cili është mendimi i ekspertëve dhe publicistëve nga këto tre vendet sa i përket ndikimit të referendumit në hapësirën shqiptare dhe më gjerë atë rajonale.

## HAP INKURAJUES PËR EKZISTENCËN SHQIPTARE NË BALLKAN

Publicisti i njohur nga Kosova, Musa Sabedini, është i bindur se sh-

qiptarët e Maqedonisë do të jenë zëri vulosës i së ardhmes së Maqedonisë, rreth emrit që parashihet të mbahet më 30 shtator përmes Referendumit. "Personalisht mendoj se nëse do të kishte një votim pozitiv nga pjesa shqiptare, atëherë do të kishte edhe një siguri dhe një garanci më të madhe të vet faktorit shqiptarë dhe të drejtave të saj. Shqiptarët në Maqedoni duhet ta kuptojnë se e ardhmja e Maqedonisë dhe anëtarësimi i saj në NATO dhe BE është hap inkurajues edhe për vet ekzistencën e popullit shqiptar atje", thekson Sabedini. Sipas tij, aty ku ka marrëveshje ndërkombëtare dhe aty ku kërkohet me Eferendum popullor të vuloset e ardhmja e një shteti, nuk ka asnjë të keq, ndërsa pala shqiptare duhet ta ndihmojë këtë proces dhe ta avancojë rolin e saj historik.

"Duhet të jetë e qartë se Maqedonia pa pjesën shqiptare është gjysmake, është e vdekur. Ky fakt na jep të drejtë të kuptojmë se shqiptarët në Maqedoni kanë përgjegjësi historike që të jenë pjesë e këtij procesi të rëndësishëm dhe vendimtar. Mund të ketë zëra kritik dhe kundërshtues, por argumenti historik flet në favor të daljes në Referendum dhe vulosjes së Maqedonisë, si shtet që garanton të drejtat e shqiptarëve, ashtu siç ka nisur me hapat e 'mëdhenj' Zaevi, ndonëse ka ende për të bërë më të mundshmen dhe më të mirën", thotë Sabedini. Rreth impaktit ndër shqiptar dhe rajonal që mund të ketë ose sjell Referendumi, Musa Sabedini thotë se kjo e bënë faktorin shqiptar,



BEKIM BALIQI

Anëtarësimi në NATO e rrit mundësitë e bashkëpunimit më të madh diplomatik, ekonomik e politik mes Maqedonisë, Kosovës dhe Shqipërisë. Me këtë, edhe populli shqiptarë përfiton, sepse faktorizohet edhe në rrafshin rajonal e ndërkombëtar. Sikurse që demonstroi edhe qëndrimin properëndimor të tyre

politikën shqiptare dhe shoqërinë shqiptare si një element vendimtar.

Siç thotë ai, ky impakt tregon se shqiptarët në rajon janë popull aktiv dhe e dinë rolin dhe rëndësinë që ka çdo marrëveshje që ruan dhe mbron kufijtë dhe avancojnë të drejtat në maksimum të vet shqiptarëve të shkelur ndër vite.

"Rajoni në përgjithësi do të ndihet më stabil dhe më i sigurt nëse Maqedonia integrohet plotësisht në NATO dhe BE, sepse kështu rriten përgjegjësit e Maqedonisë ndaj kërkesave në vazhdimësi që ka shoqëria shqiptare për tu avancuar në shkollim, arsimim, shërbime ushtarake, avancime akademike, diplomatike, përfaqësim të barabartë në të gjitha nivelet shtetërore", thekson Sabedini.



ILIR KULLA

Sjellja unilaterale e LSDM-së nuk e ndihmon këtë proces. Në kontekstin shqiptar duhet të marrin pjesë sa më shumë qytetarë të etnisë shqiptare, por edhe ata me prejardhje turke, serbe, rome etj. Në rrafshin shqiptar, dështimi i Referendumit do të ishte një goditje e rëndë për faktorin shqiptar, i cili është pro anëtarësimin në NATO

I një mendimi më të është edhe profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, Bekim Baliqi lidhur me ndikimin pozitiv në rajon të Referendumit në Maqedoni. Siç thotë profesori Baliqi, një Maqedoni stabile dhe e anëtarësuar në NATO, është në favor të shqiptarëve.

"Gjithashtu, kjo e rrit mundësitë e bashkëpunimit më të madh diplomatik, ekonomik e politik mes Maqedonisë, Kosovës dhe Shqipërisë. Me këtë, edhe populli shqiptarë përfiton, sepse faktorizohet edhe në rrafshin rajonal e ndërkombëtar. Sikurse që demonstroi edhe qëndrimin properëndimor të tyre", thekson Baliqi, duke shtuar se anëtarësimi në NATO mund të ndikojë në përmirësimin e klimës për investime dhe zhvillim ekonomik, prej së



mund të kalojë pa ndikim pozitiv edhe në Serbi, atje ku forcat radikale do të kuptojnë se hapësira ajrore e NATO-s është zgjeruar në të gjitha anët, në Mali të Zi, Bullgari, Rumania e Hungari. Këtu duhet kujtuar nenin 5 të Paktit të NATO-s ku thuhet se 'një për të gjithë, të gjithë për një! Pra, në rast të ndonjë sulmi nga jashtë të ndonjë vendi anëtarë. Andaj edhe Serbia pres që të kuptojë se të qenurit anëtar i NATO-s do ti sjell stabilitet afatgjatë dhe më shumë demokraci institucionale, sidomos në institucionet e rendit dhe sigurisë", thekson Ramadani.

Historiani i njohur nga Bullgaria, Stefan Ivanov, vlerëson ndërkohë se Referendumi për emrin do të jetë test për Maqedoninë se a do të fitojë përballë hijeve të së kaluarës. Sipas tij, Bullgaria ka interes që Referendumi më 30 shtator të jetë i suksesshëm pro marrëveshjes mes Zaevit dhe Ciprasit.

"Do të jetë një test për Maqedoninë se në cilin drejtim dëshiron të vazhdojë, a do të jetë nën hijen e së kaluarës apo do të afrohet drejt BE-së dhe do të tejkalojë gënjeshtat që shënohen në librat maqedonase", deklaroi Ivanov për televizionin bullgar OnAir. Sipas tij, është çështje e rëndësishme se a do të rikthehet ky vend tek rrëfimi fals ruso-serb se Maqedonia është diçka ndryshe. Ai thekson se për momentin zgjedhja është mes të kaluarës dhe të së ardhmes.

#### ZAEVI TË MOS SHPRESOJË VETËM TEK SHQIPTARËT

Ndërkaq, kritik ndaj qasjes së Qeverisë së Maqedonisë, me theks për kohën e papërshtatshme dhe në pyetjen e Referendumi për gazetën KOHA prononcohet analisti politik nga Tirana, Ilir Kulla.

"Së pari, unë mendoj që Referendumi është organizuar në një kohë të papërshtatshme pasi fundi i shtatorit nuk është periudha e përshtatshme për shkak se mërgimtarët e kanë të pamundur të kthehen një muaj pas pushimeve për të votuar Referendumin. Së dyti, mendoj se duhet të ishte bërë vetëm një pyetje në formularin e Referendumi, fakti sepse më shumë se një pyetje e komplikon leximin e këtij rezultati", thotë Kulla. Ai, po ashtu thotë se Zaevi nuk duhet ta perceptojë suksesin në Referendumi një votë politike në vetën e parë, por të përfshijë në procesin publik pro Referendumi edhe shkrimtarë, sportistë, akademikë, biznesmenë, aktorë... të etnisë maqedonase që të nxisin njerëzit të votojnë dhe jo të mbetet me shpresa vetëm tek shqiptarët për rritjen e pjesëmarrjes në Referendum.

"Sjellja unilaterale e LSDM-së nuk e ndihmon këtë proces. Në kontekstin shqiptar duhet të marrin pjesë sa më shumë qytetarë të etnisë shqiptare, por edhe ata me prejardhje turke, serbe, rome etj. Në rrafshin shqiptar, dështimi i Referendumi do të ishte një goditje e rëndë për faktorin shqiptar, i cili është pro anëtarësimit në NATO", thotë Kulla. Ndërkaq, në kontekst rajonal, sipas Kullës, ky Referendum në një lloj forme vendos për ardhmërinë apo jo të influencës ruse në Ballkan. "Në rast suksesi, anëtarësimi i Maqedonisë në NATO është më se i sigurt", thotë Ilir Kulla.

## MARILENA KOPA PËR EMRIN E MAQEDONISË

# MARRËVESHJA, KORREKTE PËR TË DYJA PALËT

"Marrëveshja i jep fund kontestit 26-vjeçar dhe asnjëra palë nuk është mposhtur ose ofenduar. Edhe që të dyja palët fitojnë në sferën që e konsiderojnë për të rëndësishme, Greqia emrin, të cilin në mënyrë efektive e ndan pjesën - shtetin e pavarur nga tërësia, rajoni më i gjerë gjeografik i Maqedonisë, i cili u përket tre vendeve, ndërsa IRJM e fitoi identitetin dhe gjuhën", shkruan Kopa

Athinë, 24 gusht - Konsideroj se Marrëveshja e Prespës është marrëveshje e mirë dhe korrekte, shkruan profesoresha e Katedrës për studime ndërkombëtare, evropiane dhe rajonale në Fakultetin atinas Pandio dhe ish-deputetja nga PASOK-u, Marilena Kopa, nga kolumna e saj për gazetën "Efimerida ton sidakton". "Marrëveshja i jep fund kontestit 26-vjeçar dhe asnjëra palë nuk është mposhtur ose ofenduar. Edhe që të dyja palët fitojnë në sferën që e konsiderojnë për të rëndësishme, Greqia emrin, të cilin në mënyrë efektive e ndan pjesën - shtetin e pavarur nga tërësia, rajoni më i gjerë gjeografik i Maqedonisë, i cili u përket tre vendeve, ndërsa IRJM e fitoi identitetin dhe gjuhën", shkruan Kopa dhe shton se në interes të Greqisë është që "të mos ekzistojë vrimë e zezë në kufirin verior, e lënë në ndikimin rus dhe turk, por vendi të integrohet në institucionet euroatlantike".

Profesoresha hollësisht dhe gjerësisht



përgjigjet në një pjesë të pyetjeve që parashtrihen në opinionin grek lidhur me Marrëveshjen midis Maqedonisë dhe Greqisë, njofton korrespondentja e MIA-s nga Athina. "Si do të quhet tani banorët e Maqedonisë?" është pyetja e parë që e parashtron Kopa dhe përgjigjet se nuk do të ketë kurrfarë ndryshime, ata edhe më tej do të quhen njëjtë si edhe deri tani, për shkak se "në Greqi, termi maqedonas aludon në prejardhje gjeografike, e jo në nacionalitet". Ajo thotë se tek ne, gjërat janë më ndryshe.

"Një term gjeografik, banor i Maqedonisë, maqedonas, gradualisht fitoi karakteristika etnike, me faktin se në rajonin që sot është IRJM, banorët slovenë nuk duan të identifikohen as me serbët, as me grekët, e madje as me bullgarët. Kështu, në bazë të rajonit ku jetonte ky grup sloven, i cili në

bazë dëshironte të dallohet nga nacionalitetet e tjera sllovene në rajon, me kalimin e viteve, fitoi karakteristika të përkatësisë nacionale", shpjegon profesoresha Kopa në kolumnë. Lidhur me pyetjen për nacionalitetin maqedonas, profesoresha thotë se negociatat u janë dedikuar çështjeve materiale siç janë emri i shtetit dhe shtetësisë, e jo në tema abstrakte. "Ekziston e drejta e vetëvendosjes dhe nuk mundemi që askujt t'i themi që të mos ndjehet maqedonas ose diçka tjetër", shkruan profesoresha. Në kolumnën e saj, ajo i shpjegon edhe parakushtet për integrimin e Maqedonisë në NATO dhe BE.

Këto qëndrime dhe pozicione, profesoresha Marilena Kopa i transmetoi në konferencën akademike, që muajin e kaluar, e organizoi Ministria e Punëve të Jashtme e Greqisë.

## GJERMANIA MBËSHTET REFERENDUMIN

Shefi i diplomacisë Nikolla Dimitov realizoi takim me Josip Juratoviç dhe Martin Rozman, deputetë në Bundestagun gjerman nga partia SPD, si dhe me përfaqësues të Fondacionit "Fridrih Ebert", ku shprehi mirënjohje për mbështetjen jashtëzakonisht të rëndësishme të Gjermanisë në muajt e kaluar në drejtim të progresit të Maqedonisë në rrugën drejt BE-së dhe NATO-s. Siç kumtoi MPJ, Dimitrov është shprehur i kënaqur edhe nga roli i rëndësishëm të cilin Bundestagu gjerman e ka në këtë proces. Duke informuar për rrjedhën e reformave dhe zbatimin e Marrëveshjes së arritur për zgjedhjen e kontestit bilateral me Greqinë, Dimitrov theksoi "interesi i rritur dhe vizitat e shpeshta të zyrtarëve gjerman janë porosi e qartë për atë se çfarë Maqedonie mbështet partneri ynë më i rëndësishëm evropian dhe inkurajim i fuqishëm për hapat të cilat duhet t'i kalojmë në këtë periudhë kyçe për vendin tonë dhe për qytetarët e saj". Deputetët gjermanë Juratoviç dhe Rozman e përshëndetën progresin e dukshëm të Maqedonisë në planin e reformave dhe në procesin e afrimit drejt BE-së dhe NATO-s, veçanërisht duke e potencuar Marrëveshjen e arritur me Greqinë.

## TEVDOVSKI PËR NDARJEN E MJETEVE

# S'ka nevojë për rebalanc buxhetor për Referendumin



Veles, 24 gusht - Mjetet e ndara për Referendumin prej 80 milionë denarëve janë nga funksionet rezervë të shtetit dhe kjo nuk do të

shkaktojë rebalanc të buxhetit. Këtë e theksoi ministri i Financave, Dragan Tevdovski duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve gjatë vizitës së djeshme në Veles. "E vërtetë, do të sigurohen 80 milionë denarë, ndërsa absolutisht madhësia e tyre nuk do të kishte shkakuar rebalancim të buxhetit. Ajo është shpërndarë si plan për shpenzimin e funksioneve rezervë të shtetit", deklaroi Tevdovski. Për atë se në cilën mënyrë do të shpenzohen mjetet sqaroi se Kuvendi është propozues i autorizuar dhe sipas ligjit ka të drejtë të shfrytëzojë këto mjete. "Tani është puna e Kuvendit dhe sipas ligjit ka të drejtë të shfrytëzojë këto mjete. Mendoj se ka thirrje deri tek të gjitha grupet parlamentare të shfaqin nevojën dhe a do të jenë të kyçur në fushat, por ajo është punë para se të gjithash e Kuvendit.

Ne siguroam mjete nga propozuesi i autorizuar nga Buxheti i Maqedonisë", theksoi Tevdovski. Duke iu përgjigjur pyetjes së gazetarëve për borxhet e trashëguara të komunave, Tevdovski tha se vazhdimisht analizohet gjendja, duke theksuar se jo vetëm në njësitë e vetëqeverisjes lokale, por edhe në buxhetin qendror janë trashëguar borxhe të larta. "Ne vazhdimisht e analizojmë gjendjen, sepse jo vetëm në njësitë e vetëqeverisjes lokale, por edhe në buxhetin qendror ne kemi trashëguar borxhe të mëdha, domethënë borxhi publik në rritje të shpejtë, me obligime të papaguara ndërsa të ndërmarra. E analizojmë gjendjen dhe në atë pjesë kur do të kemi diçka si vendim në mënyrë transparente do të njoftojmë opinionin. (F.R)



## KRONIKË

## Dhunohet 14-vjeçarja nga Shtëpia për fëmijë me probleme sociale

Një vajzë 14-vjeçare nga Shkupi nga Shtëpia për fëmijë me probleme sociale, e cila ka qëndruar në pushimorën "25 maji", mbrëmë në Stacionin policor në Strugë ka paraqitur se ditën e enjte, rreth orës 16, një person i panjohur ka kryer veprime të tjera seksuale ndaj saj, informon MPB. Sipas paraqitjes, vajza ka qenë në plazh dhe më pas është nisur drejt daljes nga Struga. Atje ishte hasur nga personi i panjohur me automjet të panjohur, i cili ishte ofruar ta shoqërojë. Pas një kohe të shkurtë, personi ka ndaluar në afërsi të fshatit Kalishtë dhe e ka kryer veprimin, pas çka e ka kthyer atë në pushimore. Po ndërmerren masa për ndriçimin e plotë të rastit.

## Shemben gurët, vdes minatori në "Toranica"

Në zgafellen e minierës mbrëmë ndodhi shembja e gurëve, me ç'rast humbi jetën minatori J.P. (55) nga fshati Mozdivnjak i kriva Pallankës. Më 23.08.2018 në orët e vonshme të natës, ndodhi katastrofë natyrore - shembja e gurëve në zgafellen e minierës "Toranica" - Kriva Pallankë, ku, si rezultat i kësaj fatkeqësie, u lëndua rëndë një minator në minierën "Toranica" - Kriva pallankë, i cili si pasojë e seriozitetit të plagëve dhe llojit të plagëve, i punësuar ynë iu nënshtrua lëndimeve", informojnë nga "Ministroj" SHA Sofje dhe "Bulmak 2016" sh.p.k.nj.p. Probishtip. Për rastin janë njoftuar institucionet dhe organet kompetente, të cilat janë në vendin e fatkeqësisë. Nga kompania shprehin keqardhje dhe ngushëllime për familjen e minatorit dhe paralajmërojnë se në shenjë solidariteti kanë vendosur që shënimi i planifikuar i Ditës së Minatorëve - 28 Gushti, të anulohet.

## Një kumanovar gjendet i vdekur në Shkup

R.L. (40) nga Kumanova është gjetur i vdekur dje pasdite në afërsi të një pompe benzine në rrugën "Kej Dimitar Vllahov" në Shkup. Siç njoftoi MPB-ja, rastin në pompë e ka denoncuar një person i panjohur femër, ndërsa i punësuar i pompës së benzinës e ka informuar stacionin policor Gazi Babë. Me urdhër të prokurorit publik mbi trupin e të vdekurit do të kryhet autopsi. (O.Xh)

"MONSTRA" VAZHDON MË 31 GUSHT

# DËSHMITARI I MBROJTUR PËRSËRIT RRËFIMIN E PARA GJASHTË VITEVE



I akuzuari Fejzi Aziri kërkonte shpjegim nga dëshmitari se pse dhe cili ka qenë motivi që t'i shohë pikërisht ata edhe atë aq në hollësi, megjithëse pyetja nuk u lejua

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 24 gusht - Gjykimi për rastin "Monstra", për vrasjen e pesëfishtë në liqenin e Smillkovës nga 12 prilli i vitit 2012, vazhdon më 31 gusht me dëgjimin e dëshmitarit të mbrojtur nga ana e gjykatës.

Në seancën e djeshme gjyqësore, dëshmitari i mbrojtur iu përgjigj pyetjeve të avokatëve nga mbrojtja, pasi në seancën gjyqësore më 22 gusht përfundoi dëgjimi nga ana e PSP-së. Mbrojtja tentoi që me disa pyetje, nga ajo se si kanë qenë të veshur në seancën e kaluar, deri tek ajo se nëse është e saktë se ka qenë në vendin e ngjarjes ose për këtë ka kuptuar nga mediat, ta mposht be-

sueshmërinë e deklaratës së dëshmitarit të mbrojtur.

Dëshmitari i rrezikuar, i cili deklaratën e jep nga një hapësirë tjerët me zë të ndryshuar dhe fotografi të paqartë, disa herë përsëriti se në vendin e ngjarjes ka qenë më 9, 10, 11 dhe 12 prill, ku e ka parë "Golf3" me xhama të errësuar në disa lokacione të ndryshme, si dhe dy automjete të tjera. I pyetur se nëse atë natë ka qenë në vendin e ngjarjes, dëshmitari tha po, dhe konfirmoi se ka parë katër trupa. I akuzuari Fejzi Aziri kërkonte shpjegim nga dëshmitari se pse dhe cili ka qenë motivi që t'i shohë pikërisht ata edhe atë aq në hollësi, megjithëse pyetja nuk u lejua. Kryetari i Këshillit gjyqësor, gjykatësi Stavrev dha propozim që të dakordohet që në seancën e ardhshme të shihet edhe automjeti. Avokatja e familjeve të viktimave, Dafinka Ivanovska, tha se nga rrëfimi i dëshmitarit të mbrojtur, del shpjegim shumë i qartë dhe rrëfimi në tërësi për ngjarjen. "Si tani, ashtu edhe në seancat e deritanishme, përgjigja e tij çdoherë është e qartë dhe precize dhe me siguri mund të konfirmohet se e

flet të vërtetën", tha Ivanovska.

Avokati i mbrojtjes, Naser Raufi, pas përfundimit të gjykimit, tha se në disa situata ka mundur të konfirmohet se dëshmitari i rrezikuar nuk e ka thënë të vërtetën. "Disa herë, jo vetëm që ishte konfuz, por mund të them edhe u kap në gënjeshtër konkrete, dhe lidhur me kohën se kur i ka parë dhe në përshkrimin e personave të cilët i përmend. Duket se ky është dëshmitar i montuar dhe mendoj se motivi do të zbardhet", tha Raufi. Në seancën e djeshme, në sallën e gjykatës morën pjesë të akuzuarit Agim Ismailoviq, Haki Aziri, Sami Luta dhe Fejzi Aziri, i cili është sjellë nga burgu Shtip, ku po vuan dënim për tjetër veprë. Për ekstradim të të akuzuarve Alil Demiri dhe Afrim Ismailoviq, gjykatësi Ognen Stavrev, tha se ka marrë letër nga Ministria e Drejtësisë se procedura është në vijim. Në 12 prill 2012 tek liqeni i Smillkovës u vranë Kire Triçkovski, Filip Slavkovski, Cvetanço Ackovski dhe Aleksandar Naçevski (të moshës 18-21 vjeç) të gjithë nga Radishani, Shkupi dhe peshkatari 45 vjeçar, Borçe Stevkovski nga Cresheva.

## Huliganët e 27 prillit ankohen për montim rasti

Shkup, 24 gusht - Me fjalët hyrëse të avokatëve të të akuzuarve në lëndën "27 Prilli", për sulmet e përgjakshme në Parlamentin e Maqedonisë në vitin 2017, dje në Gjykatën Penale në Shkup është mbajtur vazhdimi i tretë i këtij procesi gjyqësor, njëri nga më të mëdhenjtë në historinë më të re të Maqedonisë. Në bankën e të akuzuarve janë ulur 33 persona, deputetë, ish-funksionarë, persona publikë, policë, prej të cilëve 31 përgjigjen për "kërcënim terrorist të rendit kushtetues", ndërsa dy për ndihmë. Në bankën e të akuzuarve në gjykatë janë Luben Arnaudov, Sasho Vasilevski, Kërsto Mukoski, Lupço Dimovski, Johan Tarçullovski, Mitko Çavkov Mitko Peshovski, Dushko L Lazarov, Goran Joshevski - Levi Oliver Popovski, Oliver Radulov, Sasho Markovski, Munir Pepiq, Abdulfeta Alimi, Elena Docevska - Bozhinovska, Ivan

Cvetanovski Boris Damovski, Bogdan Ilievski - Betmen, Vllado Jovanovski, Igor Durllovski, Stefan Mladenovski, Mihail Mladenovski, Zakaria Simovski, Mladen Dodevski, Jane Çento, Goranço Angellovski, Igor Jug, Ilia Slavovski, Vlatko Trajkov, Viliam Mihajlovski, Nikolla Mitrevski - Koljo, Aleksandar Vasilevski - Ninxa dhe Mitre Pitropovski. Në seancën e djeshme i pari fjalët hyrëse i dha avokati i të akuzuarit Ivan Cvetanoski, Dragan Peshevski. Ai theksoi se prokuroria për veprën e njëjtë deri më tani ka dhënë katër kualifikime të ndryshme juridike. Ai vlerëson se prokuroria kishte kohë të mjaftueshme që t'i kualifikojë këto ngjarje, duke theksuar se e ka kryer keq punën e tij. Avokati i Boris Damovskit, Rubin Dvojakov theksoi se në aktakuzë ishte theksuar vetëm një veprim - mbajti fjalim me tregim për vendin e tij. Ai

theksoi se pasi do të shihen të gjitha dëshmitë do të vërtetohet se klienti i tij është i pafajshëm. Sanja Alkeksiq, avokatja e Bogdan Ilievskit - Betmen, theksoi se mbrojtja me listën e dorëzuar të dëshmitëve do të dëshmojë se i akuzuari nuk e kishte bërë veprën, por i kishte realizuar të drejtat e tij. Avokati Stavre Xhikov të akuzuarit Vllado Jovanovski theksoi se me paramendim është "qëndisur" kjo akuzë politike. "Këta 'terroristë' janë identifikuar pas gjashtë muajve", tha Xhikov. Toni Menkinovski, avokati i Goranço Angellovskit, theksoi se nuk e kishte marrë me kohë aktakuzën, si dhe dëshmitë, por se disponon me autorizimin si mbrojtës, pas çka e kishte lëshuar seancën, duke komentuar se për këtë akt do ta informojë komisararin për të drejta të njeriut në Këshillin e Evropës. (O.XH)



"Kemi hyrë në një qorrsohak në të cilin nuk shohim dalje pozitive, mendoj për shtetin, se mjekët do të gjejnë rrugën e tyre. Fatmirësisht ata rrugët e Evropës i kanë të hapura, por fatkeqësisht populli i Maqedonisë do të mbetet me shërbim shëndetësor të cunguar", thekson Nevzat Elezi nga Shoqata e mjekëve shqiptarë në Maqedoni

REAGON SHOQATA E MJEKËVE

# RRITJA PREJ 5 PËR QIND E PAGAVE, NUK E NDALON IKJEN E MJEKËVE



Shkup, 24 gusht - Punonjësit e institucioneve publike shëndetësore nga shtatori do të marrin paga më të larta prej 5 për qind. Bazuar në të dhënat e Odës së punonjësve shëndetësorë, kjo masë do të përfshijë rreth 10 mijë persona, të cilët do të kenë një rritje që do të sillt nga 1000 denarë apo 15 euro e deri në 3000 mijë denarë apo 50 euro.

Me këtë vendim, sipas Qeverisë, veç tjerash synohet të luftohet edhe dukuria e largimit të mjekëve nga Maqedonia për shkak të mungesës së vendeve të punës, pagave të ulëta që sillen nga 300 deri në 600 euro, por edhe kushteve tjera për punë. "Me këtë masë, Qeveria edhe njëherë tregon përkushtimin e saj për mbajtjen e punonjësve mjekësorë në institucionet publike shëndetësore në vend. Vlerësojmë se me rritjen e kompensimit për punën jashtë orarit të rregullt, kujdestari-

ve dhe angazhimit gjatë natës, si dhe me rritjen e pagave, nga muaji shtator në mënyrë të theksuar do të përmirësohet pozita e të gjithë punonjësve në sistemin shëndetësor".

"Në këtë kuadër, dua të theksoj se po punojmë për përmirësimin e infrastrukturës së objekteve, në modernizimin e tyre me pajisje mjekësore. E gjithë kjo vlerësojmë se do të paraqesë motiv shtesë për kolegët e institucioneve shëndetësore në ofrimin e shërbimeve cilësore këtu në Maqedoni",

ka deklaruar ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, duke paralajmëruar edhe masa tjera, në veçanti vazhdimin e politikës për rritjen e pagave për mjekët specialistë deri më 100 mijë denarë apo 1.500 euro. Por, mjekët vendimin për rritjen e pagave prej 5 për qind, e shohin vetëm si zgjidhje parciale, e madje edhe nënçmuese. Nga shoqatat e mjekëve shqiptarë, thonë se zgjidhja duhet të jetë afatgjatë dhe të përfshijë edhe mjekët e institucioneve private shëndetësore që përbëjnë 50 për qind të sektorit

të shëndetësisë.

Zgjidhjen përfundimtare, Nevzat Elezi nga Shoqata e mjekëve, thotë se duhet parë në miratimin e një ligji të qëndrueshëm për mbrojtjen shëndetësore. "Kjo duhet të rregullohet me ligj dhe jo me dëshirën e ministrit apo të ndonjë qeveritari tjetër se a do të ngrejë gishtin të japë 5 për qind apo jo. Rrogat e mjekëve të rregullohen ashtu siç janë të rregulluar rrogat e juristëve, deputetëve, e kështu me radhë. Pra, ky problem nuk zgjidhet kujt si ti kujtohet, ose

me zgjidhje parciale, apo vetëm për institucionet shtetërorë, çfarë të bëjmë ne që jemi në institucione private, të lëmë punën? Të gjithë duhet të përfshihen në ligj, pra pavarësisht se ku punojnë, çështja e mjekëve duhet të zgjidhet me ligj", thotë Elezi. Nëse nuk ndërmerren masa serioze, sipas Elezit, largimin e mjekëve nuk do të ketë forcë që do ta ndalojë.

"Kemi hyrë në një qorrsohak në të cilin nuk shohim dalje pozitive, mendoj për shtetin, se mjekët do të gjejnë rrugën e tyre. Fatmirësisht ata rrugët e Evropës i kanë të hapura, por fatkeqësisht populli i Maqedonisë do të mbetet me shërbim shëndetësor të cunguar", thekson Nevzat Elezi nga Shoqata e mjekëve shqiptarë në Maqedoni. Ai thekson edhe problemin me mjekët që janë në proces të specializimit e që deri tani fare nuk janë paguar për angazhimin e tyre në institucione private apo publike. Kjo, sipas tij, edhe më shumë i motivon ata që të kërkojnë perspektivë jashtë vendit. Vendimi i Qeverisë për rritjen e pagave prej pesë për qind është kritikuar edhe nga opozita e cila vendimin e ka cilësuar si populist dhe degradues për punonjësit shëndetësorë.

## Konsumatorët do të mund të kërkojnë kompensim nëse u ndalet rryma

Shkup, 24 gusht - Komisioni special i përbërë nga tre anëtarë do të angazhohet për zhdëmtim ndaj prodhuesve dhe konsumatorëve të energjisë elektrike nëse operatorët nuk pajtohen me kërkesën për kompensim të dëmit që do të bartin konsumatorët apo prodhuesit. "Çdo konsumatorë, nëse konsideron se ka zvogëlim (pa cilësi adekuate) apo nuk ka pasur furnizim me energji elektrike me çka ka pasur ndonjë dëm, mund të fillohet procedurë për kompensimin para operatorëve të sistemit elektro-distribues, apo operatorit të sistemit të transmetimit. Në atë procedurë duhet të përfshihet edhe vlerësimi i dëmit. Nëse operatorët nuk pajtohen me kërkesën të cilën e kanë ngritur konsumatorët atëherë komisioni i përbërë prej një përfaqësuesi nga konsumatorët, një nga operatorët edhe një ekspert nga Oda e ekspertëve do të vendos dhe vlerësojë se sa duhet të jetë kompensimi", ka thënë kryetari i Komisionit Rregullator për Energjetikë, Marko Bislimovski para fillimit të seancës së sotme përgatitore. "Çdo konsumator do të ketë të drejtë të kompensimit standard të dëmit, apo ulje të çmimit për përdorim të rrejtë për 10 për qind nëse ndërprerja ka qenë 12 orë, ndërsa për çdo 12 orë do të rritet për 10 për qind shtesë, në rast të ndërprerjes së planifikuar publikuar në media e cila do të zgjas më shumë se nga e lejuara apo më shumë se 12 orë", ka thënë Bislimovski. Të drejtë për kompensim do të kenë edhe prodhuesit nëse ndërprerja zgjat më shumë se pesë orë. Qytetarët sipas Bislimovskit, do të mund të kërkojnë mes tjerash nga Inspektorati shtetëror teknik të bëjë matjen adekuate që të vërtetojë cilësinë e furnizimit apo frekuencës së energjisë elektrike me të cilën pajisen. (F.P)

AMÇAM, MAQEDONIA 2025 DHE MASIT ME APEL DREJTUAR QEVERISË

## Kundër tatimit progresiv

Shkup, 24 gusht - Oda Ekonomike Amerikane në Maqedoni - AmÇam Maqedoni, Maqedonia 2025 dhe Oda ekonomike për teknologji informatike dhe komunikative - MASIT konsiderojnë se nuk është momenti i duhur për vendosje të tatimit progresiv të fitimit personal, posaçërisht jo në formën të cilën jozyrtarisht u implikua. Nga atje vlerësojnë se vendosja e propozuar e tatimit progresiv për fitimin personal nuk do ta arrijë efektin e dëshiruar të përmirësimit të barazisë sociale dhe do ta zvogëlojë produktivitetin, punësimin dhe zhvillimin e kualifikimeve, do të rritet ekonomia gri dhe negativisht do të ndikojë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik. "Është e paqartë se si do të shpërndahen mjetet plotësuese të grumbulluara me rritje e tatimit të fitimit personal - nëse drejtpërdrejt do të shfrytëzohen për përmirësim të pabarazisë sociale ose mjetet do të shfrytëzohen për shpenzimet të përgjithshme? Në qoftë se shfrytëzohen për shpenzime të përgjithshme, efekti do të priset për shkak se nga i njëjti buxhet subvencionohet

sektori privat. Në qoftë se shfrytëzohen drejtpërdrejt për përmirësim të pabarazisë sociale dhe, siç paralajmëroi ministrja e Punës dhe Politikës Sociale Milla Carovska shfrytëzohen që të rritet shumica e asistencës sociale deri në 12.000 denarë për familje katër anëtare, atëherë masa e tillë do të sjellë deri në rritje të ardhshme të papunësisë, ulje të produktivitetit dhe punësimin dhe do ta destimulojë zhvillimin e kuadrit me kualifikim të lartë", vlerësojnë nga këto tre organizata. Në kumtesë shtojnë se masat e propozuara do ta rrisin ekonominë gri duke shpjeguar se në kontekst në të cilin popullata nuk ka besim tek institucionet e sistemit dhe ka shkallë të ulët të kënaqjes tek obliguesit për mënyrë në të cilën mjetet e grumbulluara shfrytëzohen, rritja e tatimeve do të sjellë deri në gjetje të mënyrave plotësuese dhe kreative për evazion tatimor. Për shembull paraqitja e vetëm një pjesë të fitimit në vend të shumës së plotë, pagesë të fitimit të llogarive në vende tjera, kartela

Payoneer). Sipas tyre do të zvogëlohet numri i tatimpaguesve, vështirë do të grumbullohen tatimet dhe do të rriten shpenzimet dhe kompleksiteti i grumbullimit të tatimeve. "Vendosja e tatimit progresiv të fitimit personal do të sjellë deri në rritje të punësimin joformal, me ç'rast do të zvogëlohet numri i tatimpaguesve. Tendencë që të evitohen obligimet e rritura tatimore do ta vështirësojë grumbullimin e të dhënave, ndërsa formula më komplekse dhe nevoja për kontroll më të madh të respektimit të obligimeve ligjore, do t'i rrisin shpenzimet e Drejtorisë për Të Ardhura Publike", theksojnë në kumtesë.

Ata tregojnë se masat e propozuara do të kenë edhe efekt negativ ndaj rritjes dhe zhvillimit të ekonomisë së Maqedonisë përmes derdhjes së kapitalit dhe investimeve të pakësuara dhe ikjes së trurit. "Tatimimi progresiv në mënyrë destimulative do të ndikojë në "smart" industrinë inovative të cilat gjenerojnë të ardhura më të mëdha dhe janë forca shtytëse të ekonomisë". (Z.V)



Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – teksti i pastruar Gaz, Zyrtare e nr. 167/2015, nenit 5 dhe 8 të Marrëveshjes kolektive të "M-NAV" SHA Shkup, Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në "M-NAV" SHA Shkup, dhe Pëlqimeve të marra nga Ministria e financave të RM nr. 18-8390/2 të datës 19.07.2018, nr. 18-8391/3 të datës 27.07.2018, nr. 18-8639/3 të datës 27.07.2018, nr. 18-9915/2 të datës 20.08.2018, dhe nr. 18-4553/2 të datës 19.04.2018, "M-NAV" SHA Shkup publikon

#### SHPLLJE PUBLIKE

Për themelim të marrëdhënies së punës

Për nevojën për punësim të punëtorëve për kohë të pacaktuar të punës për vendet e punës në vijim:

1. Sigurim të pronës/Ohër në Departamentin për punë të përgjithshme në Sektorin për ÇFÇJZHI - 1 (një) realizues;
2. Këshilltar në Departamentin për punë të përgjithshme në Sektorin për ÇFÇJZHI - 1 (një) realizues;
3. Realizues në Departamentin për planifikim, zhvillim dhe marrje të borxhit ndërkombëtar në Sektorin për ÇFÇJZHI - 1 (një) realizues;
4. Sigurim të pronës/Shkup në Departamentin për punë të përgjithshme në Sektorin për ÇFÇJZHI - 1 (një) realizues;
5. Këshilltar të pavarur për furnizime dhe investime në Departamentin për furnizime dhe investime në Sektorin për ÇFÇJZHI - 1 (një) realizues; dhe
6. Administrator dhe përkrahje teknike në Departamentin për resurse njerëzore në Sektorin për ÇFÇJZHI - 1 (një) realizues;
7. MET prognozues të fluturimeve në Departamentin për sigurim meteorologjik të fluturimeve në Sektorin për NF - 1 (një) realizues

Kandidatët krahas fletëparaqitjes për punësim dhe biografisë së shkurtë (CV), duhet për përbushjen e kushteve të përgjithshme të parashtrohen dokumentet në vijim:

- certifikatë e lindjes;
- certifikatë e shtetësisë;
- vërtetim nga evidenca e dënimeve të dhënë nga gjykata kompetente;
- vërtetim nga evidenca penale të dhënë nga gjykata kompetente

Dokumentacioni i lartpërmendur duhet të parashtrohet në original ose kopje e vërtetuar në noter.

Krahas kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të përbushin edhe kushtet e posaçme:

- **Kandidati me numër rendor 1, ka të bëjë për** – Sigurim të pronës/Ohër në Departamentin për punë të përgjithshme në Sektorin për ÇFÇJZHI - 1 (një) realizues, duhet të ketë të mbaruar: shkallën e IV – arsim të mesëm. Duhet të ketë së paku 1 (një) vit përvojë pune. Kandidati duhet të dorëzojë dëshmi për shkallën e IV të mbaruar – të arsimit të mesëm dhe vërtetim për përvojë pune (original ose kopje të vërtetuar në noter). Vendi i punës është në objektin e kontrollit të fluturimeve në Ohër.

- **Kandidati me numër rendor 2, ka të bëjë për** – Këshilltar në Departamentin për punë të përgjithshme në Sektorin për ÇFÇJZHI - 1 (një) realizues, duhet të ketë të mbaruar: PSP – shkalla e VII/1 (shtatë) – diplomë universitare nga sfera e shkencave shoqërore ose natyrore, së paku 240 kredi sipas SETK. Duhet të ketë së paku 4 (katër) vjet përvojë pune. Kandidati duhet të parashtrojë diplomë ose certifikatë për fakultet të mbaruar dhe vërtetim për përvojën e punës (original ose kopje të vërtetuar në noter). Gjithashtu duhet të ketë edhe kualifikime, aftësi dhe shkathtësi të tjera profesionale, kualitete personale ndërsa posaçërisht: njohje të gjuhës angleze dhe zotërim të aftësive të posaçme - punë me kompjuter.

- **Kandidati me numër rendor 3, ka të bëjë për** – Realizues në Departamentin për planifikim, zhvillim dhe marrje të borxhit ndërkombëtar në Sektorin për ÇFÇJZHI - 1 (një) realizues, duhet të ketë të mbaruar: shkallën e IV – arsim të mesëm të ekonomisë. Duhet të ketë së paku 1 (një) vit përvojë pune. Kandidati duhet të dorëzojë dëshmi për shkallën e IV të mbaruar – të arsimit të mesëm – drejtimi ekonomik ose matematiko-natyror, dhe vërtetim për përvojë pune (original ose kopje të vërtetuar në noter). Gjithashtu duhet të ketë edhe kualifikime, aftësi dhe shkathtësi të tjera profesionale, kualitete personale ndërsa posaçërisht: njohje aktive të gjuhës angleze dhe zotërim të aftësive të posaçme - punë me kompjuter.

- **Kandidati me numër rendor 4, ka të bëjë për** – Sigurim të pronës/Shkup në Departamentin për punë të përgjithshme në Sektorin për ÇFÇJZHI, duhet të ketë të mbaruar: shkallën e IV – arsim të mesëm. Duhet të ketë së paku 1 (një) vit përvojë pune. Kandidati duhet të dorëzojë dëshmi për shkallën e IV të mbaruar – të arsimit të mesëm dhe vërtetim për përvojë pune (original ose kopje të vërtetuar në noter). Vendi i punës është në objektin e kontrollit të fluturimeve në Shkup.

- **Kandidati me numër rendor 5, ka të bëjë për** – Këshilltar të pavarur për furnizime dhe investime në Departamentin për furnizime dhe investime në Sektorin për ÇFÇJZHI - 1 (një) realizues, duhet të ketë të mbaruar: PSP – shkalla e VII/1 (shtatë) – diplomë universitare nga fakulteti juridik ose ekonomik. Duhet të ketë së paku 4 (katër) vjet përvojë pune. Kandidati duhet të parashtrojë diplomë ose certifikatë për fakultet të mbaruar dhe vërtetim për përvojën e punës (original ose kopje të vërtetuar në noter). Gjithashtu duhet të ketë edhe kualifikime, aftësi dhe shkathtësi të tjera profesionale, kualitete personale ndërsa posaçërisht: njohje të gjuhës angleze dhe zotërim të aftësive të posaçme - punë me kompjuter.

- **Kandidati me numër rendor 6, ka të bëjë për** – Administrator dhe përkrahje teknike në Departamentin për resurse njerëzore në Sektorin për ÇFÇJZHI - 1 (një) realizues, duhet të ketë të mbaruar: shkallën e IV – arsim të mesëm. Duhet të ketë së paku 1 (një) vit përvojë pune. Kandidati duhet të dorëzojë dëshmi për shkallën e IV të mbaruar – të arsimit të mesëm dhe vërtetim për përvojë pune (original ose kopje të vërtetuar në noter). Gjithashtu duhet të ketë edhe kualifikime, aftësi dhe shkathtësi të tjera profesionale, kualitete personale ndërsa posaçërisht: njohje aktive të gjuhës angleze dhe zotërim të aftësive të posaçme - punë me kompjuter.

- **Kandidati me numër rendor 7, ka të bëjë për** – MET prognozues të fluturimeve në Departamentin për sigurim meteorologjik të fluturimeve në Sektorin për NF - 1 (një) realizues, duhet të ketë të mbaruar: PSP – shkalla e VII (shtatë) – ose 240 kredi sipas SETK – Fakulteti matematiko-natyror – drejtimi i meteorologjisë, pa përvojë pune. Kandidati duhet të parashtrojë diplomë ose certifikatë për fakultet të mbaruar (original ose kopje të vërtetuar në noter). Kandidati duhet të ketë njohuri të gjuhës angleze dhe zotërim të aftësive të posaçme - punë me kompjuter.

Orët e punës për vendet e punës me numër rendor 1 dhe 4 gjatë javës janë 40. Orari i punës është organizuar me ndërrime. Neto pagesa fillestare është: 23.720,00 denarë.

Orët e punës për vendet e punës me numër rendor 2 dhe 5 gjatë javës janë 40. Dita e punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:30 deri në ora 15:30, ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte. Neto pagesa fillestare është: 56.485,00 denarë

Orët e punës për vendet e punës me numër rendor 3 gjatë javës janë 40. Dita e punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:30 deri në ora 15:30, ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte. Neto pagesa fillestare është: 26.061,00 denarë.

Orët e punës për vendet e punës me numër rendor 6 gjatë javës janë 40. Dita e punës zgjatë 8 orë edhe atë me fillim prej ora 07:30 deri në ora 15:30, ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte. Neto pagesa fillestare është: 34.252,00 denarë.

Orët e punës për vendet e punës me numër rendor 7 gjatë javës janë 40. Orari i punës është organizuar me ndërrime. Neto pagesa fillestare është 80% prej 71.624,00 denarë deri në marrjen e lejes për punë.

Dokumentet parashtrohen në original ose kopje të vërtetuara në noter, në lokalet e "M-NAV" SHA Shkup në adresën rr. Makedonija nr. 25, objekti L Lazar Pop Trajkov, 1000 Shkup. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen. Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit të saj në shtypin ditor. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 8 ditëve nga dita e kalimit të afatit për paraqitje të kandidatëve..

"M-NAV" SHA Shkup

Në bazë të nenit 143 par. 3 al. 1 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/2013; 12/2014; 44/2014; 144/2014; 10/2015; 25/2015 dhe 150/2015) dhe nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15 – tekst i pastruar), IPKÇF SRNIÇKA – Shkup me datë 25.08.2018 publikon

#### SHPLLJE PUBLIKE

për pranin të punëtorëve me kohë të caktuar deri më 31.12.2018

IPKÇF SRNIÇKA – Shkup ka nevojë për punësim të:

1. DEZ 0303 G01 001 - **Përkëdhelës niveli I** - 1 (një) realizues për kohët e caktuara deri më 31.12.2018

Kandidatët për vendet e cekura të punës duhet ti plotësojnë kushtet e përgjithshme ligjore në vijim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i aftë fizikisht dhe psikikisht;
- Të njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtjeje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

- Dëshmi që nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën është dënuar për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është caktuar sjellje diskriminuese. Përpos kushteve të përgjithshme ligjore kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme:

- Për vendin e punës **Përkëdhelës** - të mbaruar arsim të mesëm katërvjeçar dhe licencë valide për përkëdhelës me dhe pa përvojë pune;

Orari i punës së punëtorëve është 40 (dyzet) orë në javë nga e hëna deri të premten prej orës 07:00-15:00.

Rroga bazë për Përkëdhelës është 14.779,00 denarë.

Kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara, me fletëparaqitjen për pjesëmarrje në shpallje, duhet të dorëzojnë:

- Diplomë/dëftesa arsim përkatës të mbaruar original ose kopje të vërtetuar në noter;
- Licencë valide për përkëdhelës original ose kopje të vërtetuar në noter;
- Certifikatë të shtetësisë;
- Certifikate nga mjeku;
- deklaratë të plotësuar me shkrim dhe nënshkruar nga kandidati që e njej gjuhën maqedonase dhe shkrimin cirilik;

- dëshmi nga gjyqi kompetent që kandidati nuk i është dënim ose sanksion kundërvajtjeje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

- Dëshmi që nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën është dënuar për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është caktuar sjellje diskriminuese;

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm dorëzohet personalisht deri te Drejtoria e Çerdhes në bul.Jane Sandanski nr.29A – Shkup apo përmes postës në adresën: IPKÇF SRNIÇKA – Shkup , bul.Jane Sandanski, nr.29A - Shkup.

Afati për paraqitje është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes.

Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 15 ditë pune pas përfundimit të afatit për paraqitje.

Personi për kontakt – Janko Ralev tel. 02/2455-512.

Fletëparaqitjet jo në kohë dhe të pa kompletuara nuk do të shqyrtohen.

IPKÇF SRNIÇKA – Shkup

REPUBLIKA E MAQEDONISË



#### Çerdhja publike për fëmijë Sniçka e Komunës së Aerodromit në Qytetin e Shkupit

Në bazë të nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2014; 199/2014 dhe 27/2016), nenit 22 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015 – tekst i pastruar; 27/2016), nenit 143 paragrafi 3 pika 1 e Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/2013; 12/2014; 44/2014; 144/2014; 10/2015; 25/2015; 150/2015; 192/2015; 27/2016) dhe Rregulloren për elementet e domosdoshme të shpalljes publike për plotësimin e vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe formës, përmbajtjes dhe mënyrës së udhëheqjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të pavërteta gjatë punësimit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 34/2015), ÇPFKA SRNIÇKA – Shkup publikon:

#### SHPLLJE PUBLIKE NR. 05/2018

Për punësim për kohë të pacaktuar të 1 (një) personi teknik-ndihmës për vendin e punës në vijim:

1. DE3 0404 A04 001 – **Enëtarëse/Shërbyese niveli IV** – 1 (një) realizues

Kushtet e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Të jetë i aftë fizikisht dhe psikikisht;
- Të njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik;
- Të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Të mos i jetë shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave penale kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese.

- Kushtet e posaçme
- Arsim fillor/të mesëm të mbaruar
- Përvojë pune: me ose pa përvojë pune

Orari i punës

- Ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orë të punës në javë 40 orë
- Orari i punës prej ora 13:30 -21:30

Neto shuma e pagesës në të holla: 12.165,00 denarë

VËREJTJE: Në pajtim me planin vjetor për punësim të ÇPFKA SRNIÇKA – Shkup për vitin 2018, punësimet parashihen për gjithsej 1 (një) maqedonase/e për persona ndihmës teknik.

Afati për paraqitje është 5 ditë pune, duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve të punës pas kalimit të afatit për paraqitje.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë fletëparaqitje për punësim me bashkëngjitje të dokumentacionit në nevojshëm në vijim:

- diplomë/dëftesa për arsimin e mbaruar përkatës – original ose kopje të vërtetuar në noter;
- certifikatë të shtetësisë;
- certifikatë të mjekut;
- deklaratë të shkruar me dorë nga kandidati se njej gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik;
- dëshmi nga gjykata kompetente se kandidati nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- dëshmi nga gjykata kompetente se kandidati nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave penale kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese;

Fletëparaqitjen për punësim kandidatët mund ta marrin nga drejtoria e ÇPFKA SRNIÇKA – Shkup në adresën në vijim: bul. "Jane Sandanski" nr. 29A – Shkup.

Fletëparaqitjen për punësim me dokumentacionin e nevojshëm kandidatët duhet ta dorëzojnë në formë letër deri në arkivin e ÇPFKA SRNIÇKA – Shkup ose përmes postës në adresën në vijim:

ÇPFKA SRNIÇKA – Shkup

bul. "Jane Sandanski" nr. 29A – Shkup

(me shenjë: "Për shpallje publike nr. 05/2018")

Personi për kontakt – Janko Ralev tel. 072-247-508.

Kandidatët janë të obliguar që të dorëzojnë të dhëna të precize dhe të sakta.

Selektimin dhe intervistën e kandidatëve të paraqitur do ta realizojë Komisioni kompetent, i formuar për realizim të procedurës për punësim.

Kandidatët e paraqitur do të informohen në kohë për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës.

Fletëparaqitjet dhe dokumentacionet e dorëzuara pas afatit, të pakompletuara dhe jo të plota nuk do të shqyrtohen nga ana e Komisionit.

ÇPFKA SRNIÇKA – Shkup





**MINISTRIA E MBROJTJES**  
REPUBLIKA E MAQEDONISË

Sipas nenit 39 nga Ligji për Shfrytëzim dhe Disponim me Pronat e Organeve Shtetërore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 78/15, 106/15 dhe 153/15, 190/16 dhe 21/18) dhe Vendimit për Dhënie me Qira të Pronave të Patundshme: nr. 44-2980/1, 44-2982/1, 44-2985/1, 44-3170 dhe 44-8296/1-17 nga data 03.07.2018 (Gazeta Zyrtare e RM nr. 53 dhe 54/18) Vendimi i ministres së mbrojtjes nr. 02-3505/1 nga data 31.07.2018, Komisioni për Pasuri të Patundshme dhe Pasuri të Tundshme i Ministrisë së Mbrojtjes, shpall

**THIRRJE nr. 02/2018**

për dhënie me qira të pronave të patundshme përmes ankandit publik - hapësira afariste përmes ofertave publike elektronike

- Lëndë e shpalljes janë dhënia me qira e pronave të patundshme – hapësira afariste të përcaktuara me Vendimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për dhënie me qira të pronave të patundshme nr. 44-2980/1, 44-2982/1, 44-2985/1, 44-3107 dhe 44-8296/1-17 nga data 03.07.2018 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“) nr. 127/18 dhe me Vendimin e ministres së mbrojtjes nr. 02-4656/1 të datës 31.07.2018, si vijon:

Nr. Ren.	Të dhënat e kadastrës mbi pasurinë e patundshme	Sipërfaqja m <sup>2</sup>	Vlera e parashikuar në denarë	Qiraja fillestare mujore në denarë pa TVSH	Afati i qirasë
1.	- ndërtesa numër 1, hyrja 1, kati PR, edhe atë: hapësira nr. 34, 36, 38 dhe 39, me sipërfaqe prej 267,80 m <sup>2</sup> , në rr. „Makedonija“, në PK 12064/1 KK Qendër 1, LP nr. 55749, pronësi e RM, shfrytëzues Ministria e Mbrojtjes	267,80	12.089.240	60.446	7 vjet
2.	- ndërtesa numër 1, hyrja 1, kati PR, edhe atë: hapësira nr. 35, me sip. prej 259,43 m <sup>2</sup> , në rr. „Makedonija“, në PK 12064/1 KK Qendër 1, LP nr. 55749, pronësi e RM, shfrytëzues Ministria e Mbrojtjes	259,43	11.757.017	58.785	7 vjet

- Procedura për dhënie me qira të pronave të paluajtshme nga pika 1 e këtij vendimi, kryhet nga Komisioni për Pasuritë e Patundshme dhe Pasuritë e Tundshme të Ministrisë së Mbrojtjes, të themeluar me vendimin nr. 02-768 / 3 të datës 01.03.2018 me përmes ofertimit publik elektronik.
- Kushtet e veçanta për aplikim në ofertimin publik elektronik për qiramarrje dhe teksti i integruar i ofertimit për qiradhënie të patundshmeve – për zyra dhe hapësira mund ta gjeni në ueb faqen vijuese: [e-aukci.finance.gov.mk](http://e-aukci.finance.gov.mk) dhe në ueb faqen e Ministrisë së Mbrojtjes [www.morm.gov.mk](http://www.morm.gov.mk)

**Komisioni për Pasuri të Patundshme dhe Pasuri të Tundshme i Ministrisë së Mbrojtjes**



**KOMUNA E KARPOSHIT**

Në bazë të nenit 2 paragrafi 1 pika 4 alineja 2, nenit 4, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 46, 47, 48 dhe nenit 49 të Ligjit për shfrytëzim dhe posedim me mjetet në pronësi të shtetit dhe me mjetet në pronësi të komunave (“Vendimi për shitje të mjeteve të tundshme – automjeteve në pronësi të Komunës së Karposhit përmes ankandit publik elektronik nr. 09-930/7 të datës 07.02.2018 të sjellë nga Këshilli i Komunës së Karposhit (“Fleta zyrtare e Komunës së Karposhit nr. 2/2018) Raportit për vlerësim të realizuar për përcaktim të vlerës së tregut të mjeteve transportuese nr. 25-5628/3 të datës 16.07.2018 të përpiluar nga “AM CERT SHPKNJ” Shkup, Komisioni për mjete të patundshme dhe të tundshme pronësi e Komunës së Karposhit publikon:

**SHPALLJE nr. 2/2018**

**Për shitje të mjeteve të tundshme – automjeteve përmes ankandit publik elektronik (Shpallja e dytë)**

**1. LËNDË E SHITJES PËRMES ANKANDIT PUBLIK ELEKTRONIK**

Lëndë e kësaj shpallje përmes ankandit publik elektronik bëhet shitja e mjeteve të tundshme – automjeteve në pronësi të Komunës së Karposhit, të cilat shiten në pajtim me Vendimin për shitje të mjeteve të tundshme – automjeteve në pronësi të Komunës së Karposhit përmes ankandit publik elektronik nr. 09-930/7 të datës 07.02.2018 të sjellë nga Këshilli i Komunës së Karposhit (“Fleta zyrtare e Komunës së Karposhit” nr. 2/2018).

**2. TË DHËNAT PËR AUTOMJETIN QË ËSHTË LËNDË E SHITJES, ÇMIMI FILLESTAR I AUTOMJETIT, GARANCIA BANKARE, HAPI MINIMAL, KOHA PËR FILLIMIN E ANKANDIT PUBLIK**

Të dhënat për automjetin	Çmimi i vlerësuar fillestar	Garancia bankare	Hapi minimal	Ora / fillimi
1. <b>Marka e automjetit AUDI Q7</b> - Tabelat e regjistrimit: SK 922 VN; - Regjistrimi i parë: 16.11.2011; - Viti i prodhimit: 2011; - Lloji i makinës: M1-UDHËTIMI; - Marka dhe lloji: AUDI Q7; - Numri i shasisë: WAUZZZ45CD009163; - Lloji dhe numri i motorit: CRC 016168; - Numri i ulëseve: 5 - Fuqia dhe kapaciteti i punës së motorit: 180KW/1967 cm <sup>3</sup> ; - Ngjyra: MET.HIRI I ERRËT /7H.	1.437.221,00 denarë	28.744,42 denarë	Pa kufizime	Ora 10:00

Çmimi fillestar i mjetit të tundshëm është shumë e vlerësuar i së njëjtit të theksuar në shfaqjen tabelore. Çmimi për shitje të mjeteve të tundshme është përcaktuar në pajtim me Raportin për vlerësimin e realizuar për përcaktim të vlerës së tregut të mjeteve transportuese nr. nr. 25-5628/3 të datës 16.07.2018 të përpiluar nga “AM CERT SHPKNJ” Shkup

**3. DATA E MBAJTJES SË ANKANDIT PUBLIK**

Ankandit publik elektronik do të mbahet me datë **17.09.2018 (e hënë)** me fillim në ora 10:00. Ankandit publik elektronik do të mbahet në internet faqen në vijim [www.e-stvari.mk](http://www.e-stvari.mk).

**4. TË DREJTË PËR PJESËMARRJE**

Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik kanë të gjitha palët e interesuara të vendit dhe të huaj fizike dhe juridike që mund të kenë të drejtën e pronësisë së mjeteve të tundshme në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin dhe të cilët përmbushin kushtet e dhëna në shpallje.

Subjektet e interesuara mund të marrin pjesë për një ose më shumë automjete me parashtrimin e Fletëparaqitjes për pjesëmarrje. Kontrolli të mjeteve të tundshme – automjeteve të cilat janë lëndë e ankandit publik elektronik palët e interesuara mund të bëjnë çdo ditë pune në afatin e caktuar në pikën 6 të shpalljes, në periudhën prej ora 09.00 deri në ora 13.00, personi për kontakt Joco Petkovski 070/235-789

**5. KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKANDIN PUBLIK ELEKTRONIK**

Subjektet e interesuara juridike dhe fizike në mënyrë elektronike parashtrorin Fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik, që duhet të përmbajë të gjitha të dhënat dhe dëshmitë të përcaktuara në shpallje. (Që të mund të parashtrorin fletëparaqitje për pjesëmarrje së bashku me dëshmitë e caktuara në shpallje secili subjekt fizik dhe juridik duhet paraprakisht të regjistrohet në faqen [www.e-stvari.mk](http://www.e-stvari.mk)). Nëse ofertuesi vetëm se ka marrë pjesë në procedurën nga shpalljet e mëhershme dhe në ankandin e realizuara elektronike të realizuara përmes këtij sistemi për atë ende vlejën emri i përdoruesit dhe shifra që i janë dhënë atij me herët – nga pjesëmarrje në procedurë të cilën e ka realizuar cila do komunë).

Dëshmitë të cilat duhet të parashtrorin së bashku me fletëparaqitjen për ankand publik elektronik, personi i regjistruar obligohet të bashkëngjisë në sistemin në formë të kopjes së skanuar të origjinalit në format PDF, dhe atë:

- Deklaratë për praninë të kushteve që janë dhënë në Shpallje;
- Garanci bankare për seriozitet të ofertës në shumë prej 2 % të shumës së vlerësuar të mjetit të tundshëm, për pjesëmarrje në ankandin publik. Krahas formës elektronike, garancia bankare për seriozitet të ofertës duhet të që përmes formës me shkrim (në origjinal) të parashtrorin në adresën – Komuna e Karposhit rr. “Radika” nr. 9 ose në Barakën 2 në Arkivin e Komunës së Karposhit deri në ora 15.30 për Komisionin për mjete të patundshme dhe të tundshme pronësi e Komunës së Karposhit. Mos dorëzimi i garancisë bankare në formë me shkrim deri te komisioni e bënë fletëparaqitjen të papranueshme dhe e njëjta do të refuzohet.
- Dëshmi për identitetin për subjektet juridike;
- gjendja aktuale nga Regjistri qendror i RM – jo më e vjetër se gjashtë muaj (për subjektet juridike të vendit);
- certifikatë regjistrimi nga regjistri përkatës në shtetit prej nga vjen (për subjektet juridike të huaja);
- Dëshmi për identitetin të subjekteve fizike;
- kopje të letërnjoftimit ose dokumentit të udhëtimit;
- E-mail adresë të parashtruesit të fletëparaqitjes, përmes së cilës bëhet procedura e regjistrimit për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, gjegjësisht do t’i dërgohen emri përdorues dhe shifra për qasje në faqen [www.e-stvari.mk](http://www.e-stvari.mk) në të cilën do të realizohet ankandit publik elektronik.

Komisioni pas pranimit të fletëparaqitjeve përcakton nëse janë parashtruar në afatin e caktuar dhe nëse janë të kompletuara në pajtim me kushtet në shpallje pas çka informon parashtruesit e fletëparaqitjeve përmes formës elektronike.

**6. AFATI PËR PARASHTRIMIN E FLETËPARAQITJEVE**

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në ankandin publik është 17 (shtatëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit të shpalljes, deri më **10.09.2018 (e hënë)**.

**7. GARANCIA BANKARE**

Garancia bankare për seriozitet të ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik i kthehet parashtruesit të fletëparaqitjes në afat prej 15 ditë nga dita e mbajtjes së ankandit publik, ndërsa garancia bankare ofertuesit më të volitshëm i kthehet në afat prej 15 ditëve nga dita e pagesës së shumës së përgjithshme të arritur në ankandin publik.

Garancia bankare duhet të jepet në valutë të Maqedonisë, nga banka e cila punon dhe bën aktivitetet bankare në Republikën e Maqedonisë, ndërsa kohëzgjatja e garancisë bankare duhet të jetë në afat deri më **10.10.2018**.

**8. PROCEDURA**

Ankandit publik fillon me publikimin e çmimit të përgjithshëm fillestar të automjetit dhe realizohet përmes licitacionit nga ana e pjesëmarrësve.

Ankandit publik do të mbahet edhe në qoftë se Shpalljes i janë përgjigjur vetëm një pjesëmarrës i cili përmbushë kushtet e dhëna në Shpallje dhe ofron çmimin fillestar.

Në pesë minutat e para pjesëmarrësit mund ta pranojnë gjegjësisht të rrisin çmimin e automjetit. Ankandit publik do të konsiderohet si i përfunduar në momentin e kalimit të kohës së caktuar në shpallje, gjatë së cilës nëse në kalimin e dy minutave të fundit të kohës së caktuar për kohëzgjatje të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve jepet ofertë, afati përfundimtar për përfundim të ankandit publik vazhdon edhe për dy minuta ndërsa do të përfundojë kur për periudhën prej dy minutave të ardhshme nuk jepet ofertë e re. Ankandit publik vazhdon pa kufi, derisa në intervalin kohor prej dy minutave ka ofertë të re.

Nëse në pesë minutat e para të ankandit publik nuk është pranuar oferta, gjegjësisht nuk është dhënë ofertë më e lartë nga pjesëmarrësi në ankandin publik, vlera e mjetit të tundshëm ulet për 2% nga shumta e vlerësuar pas çka pjesëmarrësit në ankandin publik shprehin kanë mundësi të pranojnë gjegjësisht të rrisin çmimin e automjetit pa mundësinë që pastaj të kufizohet hapi minimal i rritjes. Nëse në kalimin e dy minutave të fundit nga pesë minutat e dyta të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve pranohet oferta, gjegjësisht është dhënë ofertë më e lartë, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdon edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur në periudhën prej dy minutave të ardhshme nuk është dhënë ofertë e re. Nëse në kohëzgjatje prej 5 minutave sërish nuk ka ofertë, vlera e mjetit të tundshëm sërish ulet për 2% nga shumta e vlerësuar paraprake.

Për ofertues më të volitshëm konsiderohet pjesëmarrësi në ankandin publik i cili ka ofruar çmimin e fundit që paraqet çmimin më të lartë për shitje të mjeteve të tundshme.

Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përpilon procesverbal për ankandin e realizuar publik i cili dorëzohet tek të gjithë pjesëmarrësit në ankandin publik.

Pjesëmarrësit kanë të drejtë për Apel vetëm në lidhje me procedurën për ankandin publik, në afat prej tri ditëve nga mbajtja e ankandit publik deri te Komisioni që vendosë në lidhje me apelin në afat prej 5 ditëve nga pranimi i apelit.

Ofertuesi më i volitshëm në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit me shkrim për zgjedhje obligohet që të paguajë mjetet në pajtim me çmimin e arritur përfundimtar për automjetin në llogarinë e Komunës së Karposhit, ndërsa nëse nuk i paguan brenda këtij afati, nuk do të lidhet marrëveshje, garancia bankare do të aktivizohet, ndërsa ofertuesi në afat prej një viti nuk do të mund të marrë pjesë në secilin ankand të ardhshëm publik për mjetet e tundshme në fjalë.

Me ofertuesin më të volitshëm, në afat prej 15 ditëve të punës pas pagesës së realizuar të çmimit të automjeteve, lidhet Marrëveshje për shitje të mjeteve të tundshme. Marrëveshjen në afat prej 30 ditëve blerësi e parashtron në noter për vërtetimin e të njëjtit. Obligimi për shpenzimet për vërtetim të Marrëveshjes bie mbi barrë të blerësit.

Kjo shpallje do të publikohet në ueb faqen e Komunës së Karposhit.

**Komisioni për mjetet e patundshme dhe të tundshme në pronësi të Komunës së Karposhit**



1. Sa herë që vijnë Mbrëmjet Strugane të Poezisë, një temë nuk ndryshon: mos përdorimi i gjuhës shqipe. Ndryshojnë fituesit e Kurorës së Artë, drejtorët, anëtarët e këshillit, por jo dhe të ndërrojë praktika e mospërfilljes së gjuhës shqipe, të cilën në këtë qytet e flasin më shumë se gjysma e banorëve. Pra, assesi të fitojë urtësia e zemërgjerësia e frymës poetike, e cila nuk njihet kufi. Sepse ata që i organizojnë këto mbrëmje, kanë një dioptri, dhe vazhdojnë t'i shikojnë gjërat përmes të njëjtës dioptri që sa vjet. Dhe nuk habitin më arsyetimet. Ka dhe një nyje formale – juridike në të cilën mund të bazohet dikush, çështja e ligjit për përdorimin e gjuhës shqipe, por e cila, në të vërtetë, nuk duhet të jetë pengesë. Sivjet, si gjuha që shkon atje ku të dhemb dhëmbi, dëgjuam edhe një margaritar më tepër: ky manifestim na qenka organizuar për shkak të afirmimit të kulturës maqedonase! Nga ky "thelb" nuk don të largohet as drejtorja e sivjetme e Mbrëmjeve.

Në fillim të pluralizmit, mund të ketë qenë viti 1991 ose 1992, më kishin ftuar të marr pjesë në manifestimin poetik Ditët e Goces, në kuadër të të cilit një mbrëmje që organizuar në Dibër. I trimëruar nga erërat e demokracisë, e pashë të udhës që para se të lexoja poezinë, t'u sugjeroja (më tepër t'ua përkujtoja), se në një qytet si Dibra, do të shkonte që të ishte përdorur edhe gjuha shqipe, aq më tepër që i shkon motos së njohur të Goce Delçevit që ai botën e kupton si një fushë për garë kulturore. Unë e thashë atë që thashë, kurse gjatë darkës m'u afrua njëri nga përgjegjësit për anën teknike të organizimit, emrin e të cilit nuk a kam mbajtur mend, i cili më dha plotësisht të drejtë, me një "premtim" se këtë sugjerim "do ta kemi parasysh për herët tjetra"! Dukej se në frymën e ndryshimeve pluraliste që po ndodhin, do të mund të zinte vend edhe gjuha shqipe. Por, asnjëherë më nuk më ftoi kush të merrja pjesë në Ditët e Goces, gjë që nuk ka ndonjë rëndësi fundja, por ka rëndësi tjetra, se ai premtim që ma dha ky organizatori, nuk u përmbush ndonjëherë. Besoj se kështu ka qenë dhe ka mbetur edhe në

# Etnocentrizmi i Mbrëmjeve Poetike të Strugës

Takimet e Racinit, dhe në manifestime tjera kulturore, kurse Mbrëmjet Poetike të Strugës janë fushëbeteja më e gjerë në të cilën ka qenë më e dukshme "lufta" për të mos u përdorur gjuha shqipe, përkundër "eksesëve" që kohë pas kohe i ka bërë ndonjë poet a shkrimtar shqiptar apo injorimi politik që kanë bërë kryetarët shqiptarë të Strugës në 3-4 mandatet e fundit. Edhe mospërfillja e shqipes në mbrëmjet e sivjetme nuk është asgjë e re, pos një vazhdimësi "logjike" e logjikës së organizatorëve. Pyetja është pse do ta ndryshonin praktikën sivjet, a ka ndryshuar gjë?

Duket qartë se nuk ka se si të ndryshojë brenda nate koncepti mental i organizatorëve. Këtë më së miri e tha njeriu i parë, i cili nuk parapëlqen të politizohen mbrëmjet, por i cili me shpjegimin se ky manifestim është themeluar për të afirmuar kulturën maqedonase, shumë qartë e definoi "konceptin" dhe dimensionin politik, ose përjashtimin e vlerave kulturore të popujve të tjerë nga kjo hapësirë. Nga ana tjetër, edhe sivjet, drejtorja e Mbrëmjeve ka një alibi formale juridike, atë të ligjit për përdorimin e gjuhëve, i cili ndonjëse e zgjeron përdorimin e gjuhës shqipe si në nivel të pushtetit qendror, si në atë lokal, ende nuk ka hyrë në fuqi, gjë që e theksoi edhe ministri i Kulturës, Asaf Ademi, i cili vetë foli në tri gjuhë në ditën e hapjes solemne të manifestimit poetik. Por, duhet thënë se, argumenti i të drejtës së përdorimit të gjuhës, siç e kam theksuar edhe në shumë kolumna në shtypin maqedonas, nuk është dhe nuk duhet të jetë pengesë. Sepse, prej sjelljes së Ligjit për pushtetin lokal, gjuha shqipe është zyrtare në shumë komuna, duke përfshirë edhe Strugën. Mbrëmjet Strugane të Poezisë kanë karakter të manifestimit shtetëror, por ato nuk janë vetëm të tilla, sepse me dekada komuna merr pjesë

drejtpërdrejt pothuajse si koorganizatore, shpesh edhe me mjete buxhetore, por edhe si logjistike, prandaj jo rastësisht edhe emri i manifestimit poetik ka dhe notë të theksuar lokale. Prandaj, drejtoritë e deritashme të festivalit, të paktën që nga Marrëveshja e Ohrit, e ka shpërfillur obligimin ligjor për të përdorur gjuhën shqipe në një manifestim në komunë me shumicë shqiptare.

Por, si duket, do të duhet t'ua "fallim" edhe sivjet organizatorëve, sepse me hyrjen në fuqi të ligjit (shpresojmë që të gjendet formula për të hyrë në fuqi pasi kryetari Gjorge Ivanov nuk dëshiron ta nënshkruajë "ligjin jokush-tetues) dhe vitin ardhshëm nuk do të kenë më si të arsyetohen. Aq më tepër nëse në krye të Ministrisë së Kulturës qëndron një ministër shqiptar, për mjetet që i ndan kjo ministri mund edhe të kushtëzohen me respektim ligji. Duhet thënë se në politikën kulturore do të duhej të rishqyrtohet etnocentrizmi i këtyre mbrëmjeve poetike, sikundër edhe i shumë manifestimeve kulturore (duke përfshirë edhe ndonjë manifestim që organizohet nga subjekte shqiptare (bie fjala, edhe pse është manifestim ndërkombëtar, në Ditët e Naimit përdoret gjuha shqipe dhe gjuha angleze, por jo dhe gjuha maqedonase), ku do të duhej të vihet si kusht ligjor përdorimi i të gjitha gjuhëve zyrtare, si shembull i mirëfilltë i multikulturës, e jo vetëm deklarativ. Drejtori i Mbrëmjeve Strugane të Poezisë, Mite Stefovski në hapje të festivalit mbajti një fjalim domethënës: "Asnjëherë më parë nuk janë përdorur kaq shumë tela me gjemba për t'u nënvizuar kufijtë. Meridianet të krijuar në tela me gjemba që e rrethojnë hapësirën poetike. Prandaj, ja ku jemi këtu në këto hapësira nga ku poezia, si anijet e vogla të letrës, do të shkojë nëpër botë, duke kaluar të gjitha pengesat, duke kaluar të gjithë ndalimet



Nga  
Daut DAUTI

**Drejtori i Mbrëmjeve Strugane të Poezisë, Mite Stefovski në hapje të festivalit mbajti një fjalim domethënës kundër kufijve, pengesave, ndalimeve... Por, të flasësh në parim për gjemba, tela, kufij... që duhet t'i rrënojnë poezia, e të vesh kufi të brendshëm midis gjuhëve që vendi yt i pranon si zyrtare, disi duket në kundërshtim me porosinë që e jep, sepse të qenit kozmopolit me fjalë, nuk shkon me të qenit etnocentrik në vepër!**



dhe kufijtë, duke dëshmuar për frymën kozmopolite të përfshirë në thelbin e këtij festivali". Por, të flasësh në parim për gjemba, tela, kufij... që duhet t'i rrënojnë poezia, e të vesh kufi të brendshëm midis gjuhëve që vendi yt i pranon si zyrtare, disi duket në kundërshtim me porosinë që e jep, sepse të qenit kozmopolit me fjalë, nuk shkon me të qenit etnocentrik në vepër!

2. I gjithë publiku, sidomos media, ka herë po flet për procesin dramatik të migrimit. Vetëm në një qytet si Struga, ka 900 nxënës më pak të regjistruar në shkolla. Procesi që ka filluar më herët, sidomos pas heqjes së vizave nuk ka të ndalur, ndërkaq as kjo qeveri nuk ka formulë magjike si ta ndërpresë. Ka shumë sektorë të goditur nga migrimi, por si më dramatik mund të merret rreziku i ikjes së kuadrove nga sektori i shëndetësisë, për çka lipsen masa urgjente parandaluese. Dhe, duket se kjo qeveri "po bën" diçka dhe prej 1 shtatori mjekët dhe infermieret do të kenë 5 për qind rroga më të larta! Paramendoni, 5 për qind! Sindikata doli me qëndrim se kjo është e pamjaftueshme, kurse ministri Filipçe tha se kjo është veç fillimi. E kuptojmë edhe njëherë, edhe palën tjetër, por unë them se në këto rrethana kur qeveria me politikën e saja duhet ta ndërpresë zbrazen e spitaleve nga mjekët, gjëja më e vogël që duhet të bëjë, duke krahasuar madje mjete nga ndonjë sektor tjetër (bie fjala nga ato 40 milionë që iu dhanë firmave edhe ashtu të suksesshme të sektorit privat në emër të inovacioneve), që t'u jepet motiv mjekëve të mos shikojnë perëndimin! Nëse Qeveria nuk e kupton se në këtë sektor nevojitet urgjentsisht rritje më të madhe të pagave, sot e jo nesër, atëherë nesër mund të mos ketë kë të stimulojë për të mbetur!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distributimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premtje 24 gusht | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distributim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



Winston Churchill, një nga kryeministrat që do të linte gjurmë pozitive në histori si rrallë politikanë, pat thënë: "argumenti më i mirë kundër demokracisë është një bisedë 5 minutëshe me një votues të zakonshëm". Kështu ky anglez sa babaxhan aq edhe sarkastik do të na sillte një nga formulat më të thjeshta por më të sigurtat për të testuar demokracinë dhe të mirat e saj, në një vend.

Kështu le të përdorim pikërisht këtë metodë për të parë këtu në vendin tonë se si dhe sa ka funksionuar sistemi demokratik i shtetit. Të gjitha partitë qeveritare kanë folur në emër të rrymave që në thelb kanë pasur lirinë dhe mirëqenien e individit. Mirëpo a është zbatuar dhe a zbatohet ky kontekst tek qytetari? Zakonisht të gjithë kryetarët e partive qeveritare jetojnë në disa rreth mashtroese që për fat të keq ju ndërtohen nga disa varshmërit e tyre. Në ekipet që drejtuesit e institucioneve shtetërore nuk mungojnë asnjëherë të paktën nga 2 apo 3 individë, të cilët sigurinë e vendit të tyre të punës e masin duke i bërë përkulje shefit! Qëllimi i tyre është optimizimi i Eprorit, qoftë edhe me kushtin e një realiteti të rremë!

Madje pjesa më e madhe e diktatorëve kanë qenë njerëz naiv, të cilët ishin viktimë e disa individëve që i mbanin në surealizëm, duke ndërtuar rreth tyre një botë krejtësisht imagjinare! Shembuj të tillë

## Test i Churchillit

**Pjesa më e madhe e votuesve të zakonshëm gjenden në mërgim, pasi e ardhmja e tyre në këtë shtet është fikur. Ata janë aq të dëshpëruar nga i ashtuquajtimi shtet sa kanë lënë shtëpitë e tyre, për t'ju dorëzuar vendeve të huaja, për të cilat tregojnë se i mbajnë më mirë! Një grup tjetër shumë i madh i votuesve të zakonshëm janë të papunë, janë ata që i kanë sytë e ndezur nga pamundësia e të jetuarit! Janë prindërit që nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të paguar faturat e ujit dhe rrymës! Janë studentët me diploma të harruara në raftë**



ka me qindra, si për shembull në Korenë e Veriut që thonë se ende besohet që përfaqësuesja e tyre në futboll, ka fituar Kampionatin Botëror të Futbollit. Në Shqipëri në komuniste besohet se pas Ish-Bashkimit Sovjetik, Shqipëria ishte fuqia e dytë në botë, që edhe pse me një popullsi as 3 milionë banorë gjatë asaj periudhe, ky shtet ishte gati të mposhte Ushtrinë Amerikane me një të mbyllur të syve!

Histori të tilla tingëllojnë komike dhe sigurisht përralla që mund t'i besojnë vetëm fëmijët e moshës 3-4 vjeç, mirëpo në vendet ku janë besuar kanë shkaktuar dëme të pa imagjinueshme si varfëri, krime, eksod, zhdukje të papritur të njerëzve, regjime totalitare që janë fshehur nën flamujt e dashurisë për popullin. Gjithsesi këto shembuj që u përmendën i përkasin Koresë së largët dhe Shqipërisë së dikurshme. Le të vijmë këtu, në vendin tonë dhe le të përiqemi të bëjmë një bisedë 5 minutëshe si thotë Churchill-i me një votues të zakonshëm. Duhet theksuar se me termin "të zakonshëm" nuk nënkuptohet ndonjë racë më e ulët njerëzore, nënkuptohet shumica e popullsisë, ata që duhet të

punojnë si mësues, rrobaqepës, mjekë, zdruckthetarë, inxhinierë, zjarrfikës, profesorë apo të Rinjtë mbi 18 vjeç që duhet të projektojnë shtetin e të ardhmes me votën e tyre!

Si fillim, pjesa më e madhe e votuesve të zakonshëm gjenden në mërgim, pasi e ardhmja e tyre në këtë shtet është fikur. Ata janë aq të dëshpëruar nga i ashtuquajtimi shtet sa kanë lënë shtëpitë e tyre, për t'ju dorëzuar vendeve të huaja, për të cilat tregojnë se i mbajnë më mirë! Një grup tjetër shumë i madh i votuesve të zakonshëm janë të papunë, janë ata që i kanë sytë e ndezur nga pamundësia e të jetuarit! Janë prindërit që nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të paguar faturat e ujit dhe rrymës! Janë studentët me diploma të harruara në raftë, pasi nuk punësohen dot askundi!

Janë pleqtë që vdesin para kohe nga trishtimi i varfërisë dhe i ikjes së fëmijëve! Janë dhe ata që kanë familjarët e dënuar në gjyqe të montuara, që kalben padrejtësisht në qeli të errëta burgjesh! Janë dhe ata që as nuk e dinë ku i kanë dhe kush ja ka zhdukur familjarët! Janë ata që për një vendim punësimi

trajtohen si kafshë shtëpiake nga eprorët e tyre, që për çdo pagë që marrin ju vdes edhe më shumë dinjitetit! Ka ende, por le të themi që ky është një skaner i votuesve të zakonshëm të Maqedonisë se në rastin e një rezonance magnetike sigurisht që do dilnin dhe shumë informacione të rënda.

Kush e ka fajin për këtë situatë? Ata vartës që vetëm për të mbushur xhepat, mashtrojnë drejtuesit e tyre?! Ata drejtues që janë aq naiv dhe të paafët sa ju besojnë?! Ata drejtues që nuk kanë qëllim tjetër veçse pasurimit personal?! Populli që nuk i dënon, por zgjedh të ikë?! Partitë që më shumë shahen me njëra-tjetrën se sa punojnë për popullin?! Të gjithë! Fajin e kemi të gjithë! Nëse do të bënim tashmë një bisedë me z.Churchill, do i thoshim që testi i sistemit demokratik në Maqedoni nuk na dha rezultate pozitive, burri i zgjuar do na përgjigjej: kurrë, mos u dorëzoni kurrë!

Le të vazhdojmë përpara, ne, votuesit e zakonshëm që kemi në dorë ndryshime të Jashtëzakonshme!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)



Nga  
Dr.Arben TARAVARI

## Rrethi sa vjen e ngushtohet

Çfarë dite në Uashington! Dy ndër më të besuarit e Donald Trumpit duhet të qëndrojnë për një kohë të gjatë në burg. Ish-menaxheri i fushatës elektorale Paul Manafort gjendet fajtor në disa prej pikave të aktakuzës për evazion fiskal. Pothuajse njëkohësisht me të ish-avokati i Trumpit Michael Cohen pranon fajin para gjyqit, se ka bërë shkelje të rregullave gjatë financimit të fushatës elektorale, e madje e ka bërë këtë nën udhëzim. Për të gjithë kundërshtarët e Trumpi këto janë lajme të mira.

Në rastin Manafort në epëndër nuk ishte çështja, se deri në çmasë ekipi elektoral i republikanëve ka pasur marrëveshje ilegale me përfaqësues të qeverisë ruse, për të dëmtuar rivalen e Trumpit në fushatë Hillary Clinton. Megjithatë kjo temë ende luan një rol të rëndësishëm - edhe në një proces tjetër që fillon në mes të shtatorit. Cohen e pranoi fajin duke pohuar, se ka vepruar sipas udhëzimeve të "një kan-

**Dy dështime të rënda për Donald Trump: Megjithatë është herët të mendosh për fundin e presidencës së tij**



didati" duke u paguar para që të heshtin dy grave, me të cilat siç duket Trump ka kryer marrëdhënie seksuale, "për të influencuar një zgjedhje". Trump është përjetuar në mënyrë të përsëritur, se as nuk ka pasur kontakte seksuale dhe as nuk janë derdhur para. Nëse Cohen është fajtor në aspektin juridik, atëherë Trump është gjithsesi fajtor.

### TË FALA NGA WATERGATE DHE LEWINSKY

Praktikat ilegale në fushatë elektorale dhe përgënjeshtrimi i marrëdhënieve jashtë martesore - që të dyja këto lloj aferash kanë

zënë tashmë një vend të rëndësishëm në librin e historisë së personaliteteve të SHBA-së: Në rastin e parë - afera Watergate, prej së cilës më 1974 iu desh të japë dorëheqjen presidentit Richard Nixon, në mënyrë që t'i shpëtonte një procedurë të shkarkimit nga posti. Në rastin e dytë një proces i tillë u hap ndaj Bill Clinton, sepse ai kishte pasur marrëdhënie seksuale me praktikanten Monica Lewinsky, por e pati mohuar këtë nën betim. Procesi në fund dështoi, por reputacioni i Clintonit u cenua ndjeshëm. Edhe pse po bëhet gjithnjë e më e qartë, që Trump ka bërë truke në fushatën elektorale, ka dhënë rryshfet e ka mashtruar, arsye të forta këto për një proces shkarkimi nga posti, ende nuk ka shenja për një veprim të tillë. Sepse për këtë procedurë fillimisht do të duhej të votonte dhoma e përfaqësuesve me një shumicë të thjeshtë dhe senati me shumicën e dy të tretave. Përderisa republikanët aktualisht kanë shumicën në të dyja dhomat një votë

kundër presidentit duket e pamundur - e po ashtu është e pamundur që demokratët në zgjedhjet e ndërmjetme në nëntor të mund të arrijnë shumicën përkatëse në të dyja dhomat.

### NJË VEND THELLËSISHT I PËRÇARË

Për çfarëdo që të akuzohet presidenti - një pjesë e mirë e popullsisë vazhdon ta mbështesë Trumpin. Madje njoftimet për devijime të presidentit konsiderohen nga simpatizantët e tij si propagandë dhe Fake-News të një shtypi mashtrimesh - të tilla akuza absurde lëshohen madje çdo ditë përmes tweet-ve me mllëf nga vet presidenti. SHBA-ja është një vend thellësisht i përçarë: përkrahësit e Trumpit dhe kundërshtarët e tij nuk arrijnë të pajtohen as mbi një bazë të përbashkët faktesh, prrej nga mund të gjykoreshin veprimet e këtij personi - një rrethanë kjo, që na bën të shohim me shqetësim ndaj kulturës politike të kësaj demokracie


me shumë traditë. E pra mbeten gjykatat të gjykojnë: në sfondin e dënimeve afatgjata që i kërcënojnë ata, është e mundur, që si Cohen edhe Manafort të bashkëpunojnë me hetuesit. Nuk do të ishte e habitshme, nëse më pas do të bëheshin publike të tjera fakte të pakëndshme. Megjithatë, nëse do të arrihet deri në një akuzë ndaj presidentit. kjo është e dyshimtë, sepse ai gëzon imunitetin politik të postit - të paktën sa u përket akuzave që prekin detyrat e tij zyrtare. Juristët nuk duhet të grinden për çështjen, nëse ndër akuzat bëjnë pjesë edhe ekspeditat seksuale të Trumpit para zgjedhjes së tij. Ai vet madje është i mendimit se ka kompetencat që ta falë vetveten. Duket pra, sikur burri në shtëpinë e bardhë pavarësisht dobësive të karakterit të tij mund ta vazhdojë i patrazuar avazin e tij politik - thjeshtë sipas motos: "meqenëse i ka dalë boja, mund të qeverisë tani lirshëm". E ky është një lajm i keq në këtë ditë të paharrueshme në SHBA. (DW)



Nga  
Martin MUNO



## FJALËKRYQI KLASIK





**HORIZONTALISHT:** 3. Tërheq; 5. Derdh lot; 7. Ashti më i madh në skeletin e njeriut; 9. Mizor; 10. Ndajfolje, përqark; 12. Lloj gjysmëmajmuni afrikan; 13. Ish kryetari shqiptar, Alia; 15. Vjershë lirike prej 14 vargjesh; 16. Bixhoz; 18. Element fjalëformues (akëcili, akëkush); 20. Bebëza e syrit; 23. E kaltër; 24. Tempulli pagan, ku gjoja parashikonin të ardhmen; **26. Mbiemri i regjisores kosovare (në foto);** 28. Surja e fundit e Kuranit; 29. Lëndë e parë për prodhimin e materialeve plastike; 30. Ish trajneri kosovar i boksit, Nimani; 31. Ndejë, me qëllim socializimi e rekreacioni; 33. Ish futbollist i Barcelonës; 41. Aktorja amerikane, Xhoan; 42. Bimë barishtore (patlixhan); 43. Kokë (frengj.); 44. Autori anglez, Mark (shq.); 47. Copa e qëndisur e një petku; 48. Vezët e peshqive; 49. E kundërta e vëllaut.

**VERTIKALISHT:** 1. Pjesë e këmbës; 2. Lëndë plasëse, pluhur; 3. Plasë, e çarë; 4. Lëng që rrjedh nga hundët; 5. Tërësia e fijeve të holla që mbulojnë trupin; 6. Fill pambuku me ar, për zbukurim të veshjeve; 8. Bakër; 9. Ngjyra e lëkurës; 11. Hanxhar, çaki; 12. Futbollisti ynë, Cana; 14. Shkurtesa e gjuhës zulu; 15. Komunë në Shkup; 17. Këngëtare amerikane; 18. Këngëtarja gjermano - turke, Lenz; 19. Aktorja kosovare, Yllka; 21. Kodër rëre, që formohet nga era; 22. Zoti; 23. Berliner Zeitung (shkurt.); 24. Një yjësi; 25. Inicialet e autores Sulkuqi; 27. Këmbëngulje; **30. Emri i regjisores (në foto);** 33. Vit; 34. Vegël; 35. Ceremoni; 36. Tenesi; 38. Njësia për rezistencë elektrike; 39. Pjesë e muajit (7 ditë); 40. Përemër vetor; 45. Poeteshë japoneze e periudhës hejane; 46. Shega.

## Kakuro

5x5 dhe 6x6

Kakuroja është kombinim i fjalëkryqit dhe Sudokut. Në vend të shkronjave shënohen numra edhe atë prej 1 deri 9. Numrat nuk duhet të përsëriten as horizontalisht e as vertikalisht. Numrat brenda fushave duhet t'i japin shumat, të cilat janë dhënë në skajet e fushave që duhet të plotësohen.








## DOMINOJA

Plotësoni fjalëkryqin duke i bartur katrorët e dhëna më poshtë. Në fushat e hijëzuara do të fitoni emrin e përrallës në fotografi.



O	R	D	A	M	B	I	S	T		A	K
N	T	E		B	I		T	O	O	L	O
I	A	R	M	A	L	B	Ë	N	A		D

M	A	K	U	S	H	J	S	T	I	T	R	O
K	R	E	N	T	A			R	L	A	B	
	I	D	I	A			S	A			U	S

I	N	I	A	N	A
M	I	M	N	G	O
	M	U	I	A	

H	I	R	Ë		A
A	T	E	M	E	R
R	Ë	N	A	M	I

N	A	L	F	T	A
I	T	A	I		V
N	O		K	A	N

	S	A	A		K
R	E	T	T	O	R
A		A	A	N	O



## Fshehësira



## DEKODIMI


Fjala e kërkuar fillon nga katrori i vogël dhe përfundon te rrethi.

Duhet të zgjidhni njëren nga katër shkronjat në secilën fushë dhe të vazhdoni në fushën tjetër.

Në fund, lexuar me radhë do të fitoni fjalën, që e plotëson vjershën e poetit Agim Metbala:

"... \_\_\_\_\_ është e ëmbël:

*Më shumë se sheqeri,  
Më shumë se karamelja,  
Më shumë se çokollata,  
Më shumë se marmelata..."*



Zgjidhja:

## Mini KENKEN


Në kutizat e dhëna shënohen vetëm numrat 1, 2 dhe 3. Ashtu si te sudoku edhe këtu në çdo rresht dhe kolonë nuk guxon të ketë numra të njëjtë. Numrat në skajet e sipërme të katrorëve e tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë tyre, operacionin matematikor që duhet ta përdorni për të arritur deri te rezultati.

3÷	1	5+
	12×	
		1




## SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "është më i madh se".




## KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 6. Vlejnë rregullat e sudokut. Numrat tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.




## ARUKONE (Çiftimi)

Bashkoni me vija numrat e njëjtë (çiftet). Vijat nuk guxojnë të priten. Duhet të përfshihen të gjitha fushat!



## NONOGRAMI

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat e dhëna e tregojnë numrin e fushave që duhet të nxihen.



## mini SKANDI me anagrame

Anagramet e mëposhtme ju japin dy vepra të poetit dhe enigmatit kosovar, në foto.

### Anagrami 1

DESHËT  
PISHINË?  
(SH=T)

### Anagrami 2

PËRSHKRUAN  
TREVËN  
(Ë=A)

<b>Mensur Mamuti</b>	ANAGRAMI 1, VEPËR E AUTORIT NË FOTO	PROVINÇE NË FILIPINE	LIKER ITALIAN BIMOR	ANAGRAMI 2, VEPËR E AUTORIT NË FOTO	POLITIKANI YNË, AHMETI
MARKË ITALIANE E MODËS					
VEGËL PËR QERPIKË					
PAFRE, I SHPËNGUAR					
SHEGA					AI QË URREN GJITHÇKA QË LIDHET ME HEBREJTË
AKTORE DHE KËNGËTARE MEXIKANE, PORTULIA					
ISH PRESIDENTI IRANIAN, ALI	POETI KOSOVAR NË FOTO	MËRTIMI GREK PËR VLORËN			
H		PIESE E LIMANIT, KU QENDROJNË ANIJET			Ë.N. ANIMAL-ASSISTED THERAPY
MBRETI I ALANËVE IRANIANË (SHEK. V)			KOCKË LARTËSI		
SHTETI I LASHTË MONGOL NË AZERBEJXHANIN E SOTËM					
METRI		JO I DITËS QIFLE AUSTRIAKE			
MAqedonia			Ë.L. FRIP LLASTIKU PËR PANTALLONA OSE FUNDE		PEJA
FSHAT NË TETOVË					PËREMËR PRONOR TEMPERATURA
N					
BANORËT E TOSKERISË					IMPULSI TË BASHKUAR
MEKANIZMI I PARË NUMERJES					UNIVERSITETI I TETOVËS KËNGËTARIA OKSA
A					
BANDËR I ASIRISË					
LANTANI			TEMPERATURA INTENSITETI		FILLOJ FLUORI
NË NDAI FOLIE, PASTAJ, MË VONË				DËSHMI	

# Sudoku

i lehtë

			9					
			4	1	3	2		6
		6			8			
	1	3	2					5
2	6						8	7
	7			9	3	4		
	2		3			4		
			8	4	1			
8			5					

mesatar

9			2	6				1
	6			5	7			
4			3					
	3		6			1		4
6								9
7	8			4		2		
				6				8
		6	9				5	
3				1	8			7

i vështirë

6	4					5		1
		1		2	5			3
					6			
	3	8			1			
9		8		7				1
		6				4	8	
2		5						7
			3	8				5
8	5							4

			1	6				
8	5			3				6
	4				2			
	1			8		7		
3		6	4		1	8		5
2			6					1
		9						
				1		7	2	
2		9		7		5		

	2		1				8	
1				5	3			4
		7		2		6		
7	9				5		4	2
		4		9			5	
			3		7		4	
5			6	3				9
	1				4		6	

	3			5				6
4			7					1
					3			
		5						
							8	3
				6	1	2		
7								
2			8	5		4	6	
	4		6	9				



## ARITMOGRIFI

Përgjigjet i shënori në rrjetin me numra (mbi foto). Pastaj, sipas rregullit "numri i njëjtë - shkronja e njëjtë", shkronjat e fituara bartni në tabelën tjetër (nën foto). Me plotësimin e drejtë të tabelës do të fitoni grupin kosovar (në foto), emrat e anëtarëve si dhe instrumentet e tyre.

	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18
1	9	16	22	28	33	38	42	46	50	54	58	62	67	72	78	84	91	
2	10	17	23	29	34	39	43	47	51	55	59	63	68	73	79	85	92	
3	11	18	24	30	35	40	44	48	52	56	60	64	69	74	80	86	93	
4	12	19	25	31	36	41	45	49	53	57	61	65	70	75	81	87	94	
5	13	20	26	32	37							66	71	76	82	88	95	
6	14	21	27												77	83	89	96
7	15																90	97
8																		98

### Legjendat e muzikës shqipe



- VERTIKALISHT:
- Nëpunës i ngarkuar të mbajë arkën
  - Çobaneshat
  - Qytet në Shqipëri
  - Etika
  - Përzjerje e çimentos me zhavorr e me ujë
  - Mbajtës i rendit shoqëror
  - Mjet luftime (shq.)
  - Djali, fëmija mashkull
  - Shtet në Amerikën Latine
  - Grupi i organizuar këngëtarësh
  - Guximtar
  - Peshore, terezi
  - Kasolle për bagëtitë në bjeshkë
  - Sporti i bardhë
  - Atdheu
  - Shkuarja për ta parë dikë
  - Ai që xhiron film
  - Shpend grabitqar, petrit.

22	56	97	6	63	31	52	81		76	19	71	12	39	91	49	69	23	78	37	45	58	34	3	94	48	
87	88	84	1	21	35	86	66	57	73	32	43	50	27	5	38	11	98		41	60	8	40	9	92	24	
79	13	83	28	75	62	46	77	20	59	18	4		33	89	15	93	70	30	2	53	80	10	42	64	54	17
55	96		72	25	26	67	51	65	16	68	95	36	7	47	74	14	90	82	85	29	44	61				

### ZGJIDHJET

FSHËHËSIRA

### NONOGRAMI

### KENKEN

### DOMINIOJA

### ARUKONE

### SUDOKU "2"

### SUDOKU

### ARTMOGRIFI

### DEKODIMI

### KAKURO

### FJALËKRYQI KLASIK

### me anagramë

### me anagramë



# SHBA KUNDËRSHTON TEORITË E "EGRA" TË DODIKUT

"Edhe një herë tjetër, ndihma e popullit të Shteteve të Bashkuara po përdoret për të mbështetur teori të egra konspirative në interes së fushatës zgjedhore në Bosnjë", ka njoftuar ambasada përmes një deklarate më 22 gusht

Lideri i serbëve të Bosnjës, Milorad Dodik ka akuzuar Shtetet e Bashkuara rreth përdorimit të agjencive të tyre për zhvillim për ndërhyrje në çështjet e brendshme dhe në procesin zgjedhor të Bosnje dhe Hercegovinës, akuzë e hedhur poshtë nga ambasada amerikane në Sarajevë. "Edhe një herë tjetër, ndihma e popullit të Shteteve të Bashkuara po përdoret për të mbështetur teori të egra konspirative në interes së fushatës zgjedhore në Bosnjë", ka njoftuar ambasada përmes një deklarate më 22 gusht.

Dodik planifikon të garojë për ulësen e serbëve në presidencën trepalëshe të Bosnjës, në zgjedhjet parlamentare dhe ato presidenciale që mbahen më 7 tetor të këtij viti. Ambasada amerikane ka akuzuar Dodikun edhe për tentim të frikësimit të partnerëve të USAID-it, teksa misioni



diplomatik ende është duke negociuar me Qeverinë qendrore të Bosnjës disa programe në vlerë të 8 milionë dollarëve për të ndihmuar në luftimin e korrupsionit. Kryeministri boshnjak, Denis Zvizdiq po ashtu ka hedhur poshtë pretendimet e Dodikut dhe ka akuzuar politikanët serbë për krijim të deklaratave "provokative" si pjesë të fushatës së tij zgjedhore. Dodik ka thënë më 21 gusht se agjencia e Qeverisë Amerikane - USAID, është duke zbatuar programin e saj për ndihma përmes organizatave joqeveritare në vend të përfshirjes së institucioneve shtetërore dhe Qeverisë. Presidenti i Republikës Serbe të Bosnjës, ka akuzuar edhe Qeverinë e këtij shteti për komplete me USAID-in në këtë çështje, teksa u ka bërë thirrje organizatave joqeveritare në Republikën e banuar me serbë që financohen nga ky trup amerikan se do të jenë pjesë

e hetimeve. Dodik, përfaqësues i serbëve të Bosnjës, ka akuzuar shpesh Perëndimin për siç është shprehur ai qasje paragjyquese kundër serbëve. Bosnja është e ndarë në dy etni: Republika Serbe e Bosnjës e dominuar nga serbët dhe Federata Myslimano-Kroate e boshnjakëve dhe kroatëve.

Të dyja etnitë janë të lidhura nga institucione të përbashkëta të nivelit shtetëror, duke përfshirë presidencën tripalëshe. Dodik është kritik i shpeshtë i SHBA-së, pasi edhe më herët ka tensionuar lidhjet me këtë shtet. Autoritetet amerikane kanë vënë sanksione kundër tij një vit më parë, si shkak të përpjekjeve për të penguar një marrëveshje për paqe në Bosnje dhe Hercegovinë.

Dodik po ashtu ka bërë thirrje për Republikë të pavarur Serbe vitin e kaluar, duke sfiduar një urdhër të Gjykatës Kushtetuese me thirrjet e tij për mbajtjen e një

referendumi për një festë që është cilësuar jokushtetuese dhe diskriminuese. Sanksionet u ndalojnë qytetarëve amerikanë të kryejnë transaksione në të cilët përfshihet Dodik, si dhe u lejojnë autoritetet amerikane të bllokojnë qasjen e tij në pronat apo asetet e tij nën juridiksionin amerikan. "Sanksionet janë rezultat i thirrjeve të Dodikut për ndarje, qasje provokuese ndaj Gjykatës Kushtetuese dhe thirrjet për tërheqje të forcave të armatosura të Republikës Serbe të Bosnjës nga ushtria", pati thënë një zyrtar amerikan për agjencinë e lajmeve Reuters një vit një më parë. Muajin e kaluar, Dodik ka akuzuar Britaninë për dërgim të specialistëve të inteligjencës në Bosnjë për të ndërhyrë në fushatën zgjedhore. Britania në anën tjetër ka thënë se ai është duke "shpikur kërcënime të rreme" në kuadër të fushatës zgjedhore.



## Hetimet pritet të çojnë në ndërprerjen e pagave për veteranët mashtrues

Prokuroria Speciale e Kosovës konfirmon se pas hetimeve, që do të zhvillohen lidhur me rastin e njohur si 'lista e veteranëve të UÇK-së', do të propozohet një aktakuzë, e cila do t'i dërgohet gjykatës që veteranëve "mashtrues" t'u ndërpriten pagat. Prokurori Sylë Hoxha, i ngarkuar për komunikim me mediat nga Prokuroria Speciale e Kosovës, tha për Radion Evropa e Lirë, se bashkë me aktakuzën, Prokuroria do të kërkojë që të dyshuarve, të cilët rrjedhimisht nuk e meritojnë pagën, t'u ndërpriten ajo. Hetimet e reja pasojnë një proces të lënë në gjysmë nga ish-prokurori Elez Blakaj, i cili dha dorëheqje me arsytimin se mbi të po bëhen presione. "Aktakuza nuk ka qenë e kompletuar nga prokurori Elez Blakaj. Kjo aktakuzë do të plotësohet, dhe në atë plotësim të aktakuzës në rastin e dorëzimit, do të kërkohet nga gjykata një gjë e tillë. Pra, Prokuroria ia propozon gjykatës pezullimin e atyre pagave të veteranëve për ata njerëz, të cilëve nuk iu takon", deklaroi Hoxha. Ai tha, po ashtu, se ende është herët të thuhet se çka do të ndodhë me ata persona të cilët kanë marrë para nga buxheti, por tani mund të vërtetohet që pagat e tyre ishin të kundërligjshme. "Tash prokurori që do të vazhdojë punën për aktakuzën, do të dalë me ndonjë konkludim konkret..., është herët të thuhet diçka", tha Hoxha.

## Në Serbi flitet vetëm për ndarjen e Kosovës

"Kosova është Kosovë dhe duhet me e pranë kështu. Duhet me u marrë më shumë me çka ka ndodhë gjatë luftërave, me viktimat e luftës, me të pagjeturit. Krejt këto janë lojëra politike që i bëjnë dëme jo veç popullit shqiptar por edhe popullit serb, se veriu i Kosovës nuk është i banuar vetëm me serbë, ka edhe shqiptarë aty...", thotë Perushiq

Derisa në Kosovë po debatohet për korrigjimin e kufijve mes Kosovës dhe Serbisë përmes një marrëveshje përfundimtare, juridikisht të obligueshme, sipas studiuesit Tomislav Lulzim Perushiq, në shtetin serb debati po bëhet për diçka tjetër, ndarjen e Kosovës. Sipas Perushiqit, atje nuk mendojnë se duhet të bëhet korrigjimi i kufijve, porse ndarja e saj. "Në Serbi nuk flitet për shkëmbimin e territoreve, flitet veç për ndarjen e Kosovës më së shumti, do të thotë marrjen e veriut të Kosovës. Mendoj që shkëmbimi i territoreve është diçka shumë e komplikuar dhe shumë e rrezikshme sepse bëhet një precedent për ndarjen e shteteve, jo veç

në rajon por edhe më gjerë. Qeveria e Serbisë, mendoj që ka për qëllim jo tamam me e marrë pjesën e Kosovës sepse bëhet fjalë për një pjesë të vogël, por e kanë për qëllim Bosnjën, ndarjen e Bosnjës dhe të ashtuquajturës 'Republika Srbska' që u krijua në 92-ën", tha ai.

Perushiq, i cili po ndjek ligjëratat e Seminarit të Gjuhës, Letërsisë dhe Kulturës Shqiptare në Prishtinë, shpreh frikën e tij se me lojërat politike që po bëhen, rrezikon një 'spastrim i mundshëm etnik'. "Kosova është Kosovë dhe duhet me e pranë kështu. Duhet me u marrë më shumë me çka ka ndodhë gjatë luftërave, me viktimat e luftës, me të pagjeturit. Krejt

këto janë lojëra politike që i bëjnë dëme jo veç popullit shqiptar por edhe popullit serb, se veriu i Kosovës nuk është i banuar vetëm me serbë, ka edhe shqiptarë aty... Po ashtu, në luginën e Preshevës nuk ka vetëm shqiptarë, ka edhe serbë që jetojnë aty. Kjo do të thoshë që edhe një pastrim etnik do të ndodhë nëse shkëmbejnë territoret. Mendoj se shqiptarët e veriut do të largohen me u shpërngul në jug, serbët e luginës po dojnë me qëndru në Serbi. Mendoj se është shumë e rrezikshme", thotë ai për KosovaPress.

Shprehja e bindjeve të tij politike, sipas studiuesit të gjuhës shqipe nuk është aq e lehtë në Serbi,



pasi që folësi mund të përballë me një mori paragjykimesh. "Unë nuk foli shumë për politikë me shoqërinë time. Unë e di se me kë mundëm me fol dhe me kë jo, sepse ka shumë njerëz kokëfortë dhe nuk ndryshojnë mendimin... Unë veç iu tregoj se shqiptarët janë njerëz sikurse krejt të tjerët dhe që janë shumë mikpritës. Bile nga përvoja ime, mendoj se shqiptarët kanë më pak paragjykime ndaj njerëzve sesa njerëzit në Serbi", tre-

goi ai. Sipas tij, njohja e ndërsjellët e gjuhëve do të bënte që shqiptarët dhe serbët të komunikonin më shumë mes vete, gjë që gradualisht do të normalizonte raportet mes tyre.

SHËNIM: Tomislav Perushiq është nga Subotica dhe ka raporte shumë të mira me shqiptarët sa që atë e thërrasin me emrin shqip, Lulzim. Ai thotë se një ditë do të shpërngulet në Prishtinë pasi dëshiron të studioj këtu.



Çfarë po ndodh në Rumania? Pse mijëra njerëz dalin nëpër rrugë për të kërkuar dorëheqjen e qeverisë, e akuzuar për korrupsion? Është nga shkurti i vitit 2017, thonë gazetaret, që qytetarët rumunë protestojnë në mënyrë të përsëritur kundër qeverisë socialdemokrate pasi "pengon luftën kundër korrupsionit". Atëherë çfarë ka ndodhur?



## RUMANIA, PËRTEJ ASAJ QË DUKET

Në shkurtin e vitit 2017, Gjykata e Apelit e Bukureshtit ka dënuar dy izraelianë të Black Cube, një "kompani private inteligjence" që përdor agjentë të Mossadit, elementë të spikatur të Tsahalit - deri pak kohë më parë kishte si President Nderi Meir Dagan, ish shefin e njohur të Mossadit - dhe furnizon klientelën e saj ndërkombëtare me "aktivitete inteligjence, gjetje provash (edhe nëpërmjet profilimit të subjekteve të interesuara dhe përdorimit të agjentëve nën kopterurë). Pastaj aktivitete të llojit asset tracing (kërkimi parash), shërbime konsulence strategjike në kundërshti multijuridiksionale". Domethënë një agjenci për të cilën nuk do shumë punë për ta kuptuar.

Në Bukuresht, të dy punonjësit e dënuar quhen Ron Weiner dhe David Geclowitz: i kishte arrestuar më pak se një vit më parë DIICOT-i (akronim i Drejtorisë Qendrore

për Hetimin e Krimin të Organizuar dhe Terrorizmit), me akuzën se kishin kryer veprime të finalizuara për të siguruar informacione me të cilat të diskreditonin Laura Codruța Kövesi, prokurorja në krye të DNA-së (akronim i Drejtorisë Kombëtare të Antikorrupsionit rumun), një "institucion i krijuar përpara hyrjes në Bashkimin Europian me objektiv luftimin e korrupsionit të nivele të larta. Kövesi ishte tashmë e njohur në Rumania: ishte një lloj gjenie. Në vitin 2006, kur ishte vetëm 33 vjeç, ishte bërë Prokurorja e Përgjithshme e parë femër në historinë e vendit dhe më pas është transformuar në simbolin e luftës kundër korrupsionit të egër qeveritar".

Ekspozite e një Mani Pulite rumune kjo Laura? Le ta lëmë për një moment këtë pistë dhe le të shikojmë pak dy personat e

sipërpërmendur. Në fakt, të dy ata u shpallën fajtorë, u dënuan me disa vite secili, por më pas u ndihmuan nga një ndërhyrje e Izraelit, që u ka siguruar lirinë dhe kthimin në ardhe. Kush i kishte rekrutuar për të kërkuar pisllekun pas Laurës? U fol për dy prej "padronëve të fuqishëm të mediave" rumune ose "rumunë" në thonjëza: që janë përkatësisht Sebastian Ghita, padroni i kanalit televiziv të lajmeve Romania TV neës station, Dan Voiculescu i kanaleve televizive Antena TV Group dhe të lajmeve Antena 3, Dan Adamescu, pronari i gazetës "Romania Libera", Adrian Sarbu, që ka në pronësi Mediafax Group, Sorin Ovidiu Vantu, ish padroni i Realitatea TV, dhe Dan Diaconescu i OTV-së, i quajtur "televizioni i parë tabloid (skandalistik) në Rumania. Të gjithë këta Padronë të Diskutimit kanë qenë subjekt

investigimesh nga ana e DNA-së së drejtuar nga Laura Codruta dhe disa prej tyre janë dënuar.

Prokurorja Laura ka fituar vlerësimin e popullsisë, e dëshpëruar nga sa duket prej klasës politike më të korruptuar që ekziston. Kështu, njerëzit nuk e kanë pritur mirë vendimin e 9 korrikut të 2018 të marrë nga ana e Presidentit Klaus Johannis, me anë të cilit ka shkarkuar prokuroren Laura: Johannis i është dashur që të zbatojë një vendim të Gjykatës Kushtetuese, që kishte sanksionuar shkarkimin e Laura Kovesi. Kjo - të mbahet mirë parasysh - pas kërkesës së Ministrit të Drejtësisë Tudorel Toader, që e akuzonë prokuroren Laura se kishte shkuar përtej mandatit të saj dhe se "nuk kishte respektuar autoritetin e Parlamentit". Ministri Toader ka qenë vetë një ish anëtar i Gjykatës Kushte-

tuese; është bërë Ministër i Drejtësisë pasi paraardhësit të tij Florin Iordache të Partisë Socialdemokrate i është dashur që të japë dorëheqjen si pasojë e protestave të dhunshme të 2017 në Rumania, të shpërthyer pas tentativës së tij për të modifikuar Kodin Penal në drejtimin e depenalizimit të krimin të korrupsionit.

Në Rumanim leximi i asaj që ndodh komplikohet akoma më shumë prej faktit që presidenti Johannis, i cili ka provuar t'i rezistojë Gjykatës Kushtetuese dhe ta mbajë Laura Kovesi në postin e saj, është një liberal i djathtë, anti-Putin, që pëlqehet nga Bashkimi Europian, ndërsa qeveria e korruptuar socialdemokrate po kërkon të afrohet me Moskën. Presidenti Klaus Johannis e kishte dënuar operacionin e policisë si të ekzagjeruar dhe ka kërkuar një hetim gjyqësor lidhur me incidentet. Ministri i Brendshëm Carmen Dan e ka justifikuar të shtunën në një konferencë për shtyp në Bukuresht procedurën e policisë me faktin që ajo ishte përballur me kriminelë të dhunshëm të rrezikshëm.

Gjë që është e vërtetë: për herë të parë, midis turmës që thërriste "Dorëheqje" për qeverinë (jo vetëm prej korrupsionit, por për reforma fiskale, të pensioneve dhe të sigurisë sociale) dhe për "Më shumë Europë", janë shfaqur grupthe të mirëorganizuara, që kanë ngjallur reagimin e policisë. Se çfarë kanë qenë, nga kanë dalë, kush i ka organizuar, mbetet për t'u parë. Tani qeveria social - liberale po mendon që të ngrejë një padi kundër Presidentit europeist Johannis me akuzën për tradhti të lartë. Le të presim ditët në vazhdim...

## Indi, vazhdojnë vdekjet nga reshjet

Të paktën 12 persona kanë humbur në dy ditët e fundit për shkak të reshjeve në shtetin Madhya Pradesh të Indisë. Sipas lajmeve në mediat lokale, për shkak të reshjeve që intensitetin e kanë rritur në dy ditët e fundit të paktën 12 persona kanë humbur jetën. Theksohet se katër nga të vdekurit janë nga e njëjta familje. Nga reshjet në 21 rajone të shtetit lumenjtë kanë dalë nga shtretërit. Instituti i Meteorologjisë njoftoi se reshjet do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim. Për shkak të shirave munsonë të shtetit indian Kerala që



po vazhdojnë 3 muaj këtë vit mbi 400 persona kanë humbur jetën.

"Po ju them këtë: tregjet do të rrënohen dhe të gjithë do të bëhen të varfër nëse ndaj meje hapet rruga për gjykim në ndonjë mënyrë", u shpreh Trump

Presidenti amerikan Donald Trump tha se tregjet do të shkatërrohen dhe njerëzit do të jenë të varfër nëse ndaj tij hapet rruga e impiçmentit. Këto komente Trump i bëri në një program në kanal amerikan Fox News, në të cilin ai foli në lidhje me pretendimet e fundit për një impiçment ndaj tij. "Nuk e di se si mund të dërgoni në gjyqësor dikë që ka kryer një punë të shkëlqyer", tha Trump, duke theksuar se ai si presidenti i SHBA-së ka bërë punë shumë të mirë, kryesisht në fushën e ekonomisë. "Po ju them këtë: tregjet do të rrënohen dhe të gjithë do të bëhen të varfër nëse ndaj meje hapet rruga për gjykim në ndonjë mënyrë", u shpreh Trump në vazhdim, duke iu referuar tregjeve amerikane. Po ashtu, ai ka mbrojtur qëndrimin e tij se falë qe-

## Tregu do të shkatërrohet nëse ndaj meje hapet impiçment



verisjes ekonomike të tij, kanë arritur një nivel shumë të mirë në bursë. "Pa këtë, ju nuk mund të besoni se si numrat do të shkonin prapa", shtoi Trump. Pasi ish-avokati Michael Cohen u dorëzua në në Byrojnë Federale të Hetimit (FBI) në kuadër të një hetimi ndaj tij dhe deklarimi i tij se do të bashkëpunojë me gjykatën, ka bërë që Trump të shprehë akuzën ndaj Cohen.

Fjalët e Cohen i cili ka pretenduar se Trump në periudhën e zgjedhjeve i ka paguar para për heshtjen dy grave me të cilat ka krijuar marrëdhënie në

të kaluarën, kanë shkaktuar debate në opinion publik nëse Trump ka gënjer apo jo në lidhje me këtë çështje. Cohen kishte pretenduar se pagesën e kishte kryer në kuadër të direktivave të Trumpit. Disa ekspertë në median amerikane mbrojnë idenë e tyre se Trump mund të gjykohej për shkelje të rregullave zgjedhore dhe pjesëmarrje në disa shkelje të tjera. Ndërkaq, Trump pretendon se gjatë këtij procesi nuk ka kryer ndonjë gabim dhe se nuk ka kryer asnjë vepër që të hapë rrugën e gjykimit të tij.

## Sulm me thikë më Francë, 2 të vdekur

Të paktën dy persona humbën jetën ndërsa një tjetër është plagosur rëndë pas një sulmi me thikë në qytetin Trappes të Francës. Një burrë, i cili dje në Trappesa në perëndim të Parisit, me thikë vrau nënën dhe motrën e tij kishte probleme serioze psikike, ka konfirmuar ministri i Brendshëm i Francës, Gerard Collomb. Collomb me rastin e vizitës në Trappesa, deklaroi se sulmi aktualisht nuk trajtohet si terrorist për kundër faktit se organizata terroriste mori përgjegjësinë për sulmin. Ai theksoi se personi i tretë i cili pësoi plagë të rënda, nuk është anë-

tarë i kësaj familje. Ministri francez tha se policia qëllon dhe vrau sulmuesin, i cili me thikë në dorë doli nga shtëpia e nënës së tij. Ai nuk reagoi pas paralajmërimeve të policisë. Organizata terroriste DEASH mori përgjegjësinë për sulmin me thikë në qytetin francez Trappesa. Zyra e Gubernatorit në Yvelines njoftoi se sulmi është kryer në orët e mëngjesit në qendër të qytetit. Radio "Europe 1" raportoi se sulmuesi i lindur në vitin 1982 kishte hyrë në shtëpi në rrugën Camille Claudel, në Trappesa dhe pas 20 minutash ka dalë me thikë në dorë.



Në bazë të nenit 21 paragrafi 1, nenit 119 dhe nenit 120 të Ligjit për shërbime gjyqësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/2014, 33/2015, 98/2015) dhe Rregullores për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës, SU03 nr. 3/2015 të datës 16.03.2015, Gjykata themelore Prilep publikon:

**SHPALLJE PUBLIKE NR. 1/2018**  
**Për punësimin e pjesëtarit të policisë gjyqësore për kohë të pacaktuar**

- Polic i gjykatës
- Numri i realizuesve..... 1 (një) realizues

Kandidatët e interesuar duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme në vijim:

- Të jetë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase;
- Të jetë të moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore;
- Të mos i jetë të shqiptuar me vendim të plotfuqishëm gjyqësor ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;

Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të nëpunësit gjyqësor të paraparë në nenin 21 të Ligjit për shërbime gjyqësore, kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme të përcaktuara në nenin 119 të Ligjit për shërbime gjyqësore dhe nenin 45 të Rregullores për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën themelore Prilep:

- Të mos jenë më të vjetër se 25 vjet,
- Të jenë të aftë fizikisht dhe psikikisht për kryerje të punës së policisë së gjykatës;
- Të kenë kualifikime përkatëse të nevojshme për vendin e punës, së paku arsim të mesëm, me ose pa përvojë pune,
- Të posedojnë kompetenca të përgjithshme përkatëse të punës të nevojshme për vendin e punës: gatishmëri për mësim dhe zhvillim, komunikim, realizim të rezultateve, punë me të tjerë/punë ekipore – orientim ndaj palëve.
- Të posedojnë kompetenca të posaçme të punës për vendin e punës: njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë dhe njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane) përmes posedimit të certifikatës pranuar ndërkombëtarisht të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian ose certifikatë nga institucioni ndërkombëtar, të nivelit A1 të CEFR, gjeqjësish BULATS ose Aptis, ose TOEFL CBT së paku 35 pikë ose TOEFL IBT së paku 10 pikë ose DELF, TCF, TEF ose Gete Certifikatë

Pagesa fillestare e përfaqësuesit të policisë së gjykatës është 18.500 denarë.

Orari i javor i punës është: 40;

Orari i punës: ndërrimi i 1 prej ora 07-15; ndërrimi i 2 prej ora 15-23; ndërrimi i 3 prej ora 23-07.

Fletëparaqitja për punësim me dëshmitë e parashtruara për përmbushje të kushteve në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter dorëzohet në formë të shkruar përmes sportelit për praninë të gjykatës ose përmes postës në adresën:

Gjykata themelore Prilep

Me shenjë: PËR SHPALLJE PUBLIKE 1/2018

Bul. "Goce Dellçev" pn, Prilep.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor.

Në pajtim me nenin 120 paragrafi 3 të Ligjit për shërbime gjyqësore, kontrollimin e kushteve për punësim të pjesëtarit të policisë së gjykatës e bën Ministria e drejtësisë së Republikës së Maqedonisë, pa i shkelur kriteret për përfaqësim përkatës dhe të drejtë të qytetarëve që i përkasin të gjitha bashkësisë.

**GJYKATA THEMELORE PRILEP**

Në bazë të nenit 22 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 120/2011, 10/2012, 11/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015 dhe 27/2016), IPKÇF "Goce Dellçev" – Komuna e Ilinden publikon

**SHPALLJE**

Për punësimin për kohë të pacaktuar

- **8 realizues për vendin e punës – Edukator,**  
Profesor i diplomuar për edukim parashkollor, Edukator i diplomuar për fëmijë të moshës parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor me 240 kredi të arritura sipas SETK, ose arsim të mbaruar sipëror shkalla VII/1 ose arsim të baruar përkatës sipëror për edukatorë dhe licencë valide për edukator, me përvojë pune.

- **5 realizues për vendin e punës – Përkëdhelës**  
Me arsim të mesëm të mbaruar katërvjeçar dhe licencë valide për përkëdhelës, me përvojë pune.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrorjnë:

- Dëshmi për arsim të mbaruar përkatës (dëftesa, diploma, certifikata);
- Certifikatë të shtetësisë;
- Certifikatë të mjekut;
- Vërtetim për njohje të gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtës ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilin është dënuar për veprë penale për dhunë familjare, marrje të fëmijës së mitur, moskujdesë ose keqtrajtim të fëmijës së mitur ose abuzim farefisnor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është vërtetuar sjellje diskriminuese

Afati për parashtrimin e dokumenteve është 5 ditë pune, duke konsideruar nga dita e ardhshme e publikimit të shpalljes.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve të punës pas kalimit të afatit për paraqitje.

Orari i punës së:

- Vendi i punës edukator është 40 orë në javë (prej ditës së hënë deri ditën e premte), ndërsa orari ditor i punës është 8 orë dhe i njëjti është në periudhë prej ora 07.00 - 16.00.
- Vendi i punës përkëdhelës është 40 orë në javë (prej ditës së hënë deri ditën e premte), ndërsa orari ditor i punës është 8 orë dhe i njëjti është në periudhë prej ora 06.00 deri në ora 18.00.

- Neto pagesa fillestare për vendin e punës:

Edukator është 19.581,00 denarë, ndërsa për përkëdhelës është 14.780,00 denarë,

Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i parregulluar nuk do të shqyrtohet.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrihen deri në:

IPKÇF "Goce Dellçev" Komuna e Ilindenit rr. 534 nr. 25 v.q. Marino – Komuna e Ilindenit

IPKÇF "Goce Dellçev"  
Komuna e Ilindenit

**URGJENTISHT**

**Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo + Pr + 1 + Nën, trualli i parë në "Momin Potok" – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithsej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960**

**URGJENTISHT**

**Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 071 372 221**

**Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor e Republikës së Maqedonisë**

**SHPALLË**

Kërkesë për dhënie e lejes për shfrytëzimin e ujit nga akumulimi Kalimanci për prodhimin e energjisë elektrike për HEC Kalimanci.

Në përputhje me nenin 30 paragrafi 1 nga Ligji për ujërat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15 dhe 52/16) deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është parashtruar kërkesë për grumbullimin e ujit nga akumulimi Kalimanci për prodhimin e energjisë elektrike për HEC Kalimanci. Vendi i shfrytëzimit të ujit nga akumulimi Kalimanci PK 3359/1 Dulica dhe derdhjes nga ndërtesa e makinerisë PK 3375, KK Dulica, Komuna e Dellçevës

Parashtruesi i kërkesës:

**EVN Maqedoni Elektronat Shkup Shkup**

Koordinatat e vendit të grumbullimit të derdhjes nga ndërtesa e makinerisë HEC Kalimanci sipas sistemit shtetërorë koordinativ janë:

**Grumbullim**

→ X=4649168; Y=7631528;

**Derdhje**

→ X=4648607; Y=7631206;

Informata lidhur me kërkesën, publiku i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor në e-mail d.naumoska@moepp.gov.mk

Publiku i interesuar, **në afat prej 15 ditësh** nga dita e shpalljes së kërkesës, ka të drejtë të parashtrorjë mendime dhe komente në formë të shkruar deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Bulevardi "Goce Dellçev" nr. 18, ndërtesa e RTVM-së (kati i 10-të), 1000 Shkup.

**KOMUNA E ÇUÇER SANDEVËS**

Kryetari i Komunës së Çuçer Sandevës

Në bazë të nenit 46 paragrafi 9 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), Kryetari i Komunës së Çuçer Sandevës, publikon

**LAJMËRIM**

Informohen qytetarët dhe subjektet juridike nga Komuna e Çuçer Sandevës se Kryetari i Komunës së Çuçer Sandevës ka sjellë vendim për organizim të:

1. Prezantim publik dhe anketë publike në lidhje me Dokumentacionin lokal planor urbanistik me qëllim G – prodhimtari, distribuim dhe shërbime në PK 3137, PK 3140/1, PK 3140/4, PK 3141/4 dhe pjesë të PK 3141/1, KK Glluvo Brazda, Komuna e Çuçer Sandevës.
2. Prezantimi publik i DLPU do të mbahet më datë 29.08.2018 (e mërkurë) me fillim në ora 10:00, në sallën e madhe të Komunës së Çuçer Sandevës
3. Anketa publike për DLPU do të zgjasë 5 ditë pune nga dita e publikimit në mjetet e informimit.

Sipërfaqja për të cilën organizohet anketë publike dhe prezantim publik për Dokumentacionin lokal planor urbanistik me qëllim G – prodhimtari, distribuim dhe shërbime në PK 3137, PK 3140/1, PK 3140/4, PK 3141/4 dhe pjesë të PK 3141/1, KK Glluvo Brazda, Komuna e Çuçer Sandevës gjendet në pjesën juglindore të KK Glluvo Brazda dhe në mënyrë administrative bie nën Komunën e Çuçer Sandevës, madhësia e sipërfaqes është 8398 m2.

Dokumentet planore do të ekspozohen në lokalet e Komunës së Çuçer Sandevës në f. Kuçevishte. Qytetarët dhe subjektet juridike të përfshirë në afatin e paraparë mund të parashtrorjnë vërejtjet, mendimet dhe propozimet e tyre përmes postës ose përmes arkivit të komunës, çdo ditë pune prej ora 09:00 deri në ora 15:00.

**KOMUNA E ÇUÇER SANDEVËS**  
**KRYETARI I KOMUNËS**  
Jovan Pejkovski

**Shkolla fillore komunale "Todor Janev" – Çashka**

Në bazë të nenit 22 dhe 23 nga Ligji për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 62/05 52/12, 54/13, 170/13 dhe 74/2015 - tekst i konsoliduar), nenit 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 103/08, 33/10, 112/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12 dhe 24/13), Drejtori i SHF "Todor Janev" Çashka vendosi të publikojë:

**SHPALLJE**

**Për plotësimin e vendeve të lira të punës në SHF "Todor Janev" Çashka për kohë të caktuar deri më 31.08.2019, si dhe për kohë të caktuar deri në 9 muaj (zëvendësim për shkak të pushimit të lindjes) dhe deri në 3 muaj**

1. **Mësimdhënës të mësimit klasor,** 1 realizues, me orar të plotë të punës, të ketë të mbaruar arsimin sipëror- Fakultetin Pedagogjik, më pagësë bazë prej 20.180,00 denarë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2019
2. **Mësimdhënës të Artit figurativ,** 1 realizues me 8 orë mësimore (4 orë në Çashka dhe 4 në Melnica) me Fakultet të mbaruar të artit figurativ, me pagesë bazë 8.357,00 denarë, për kohë të caktuar deri më 31.08.2019
3. **Sekretar,** 1 realizues me orar të plotë të punës, me fakultet të mbaruar ekonomik ose juridik dhe pagesa bazë 20.965,00 denarë, për kohë të caktuar prej 9 muajve.
4. **Mirëmbajtës të higjienës,** 1 realizues me orar të plotë të punës, me arsim të mesëm të mbaruar dhe pagesa bazë 12.100,00 denarë, për kohë të caktuar prej 3 muajve

Kandidatët për mësimdhënës duhet ti plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligjin për arsimin fillor.

Shpallja do të zgjatë 5/pesë/ ditë punë nga dita e publikimit

Me lutje të dorëzohen dokumentet në vazhdim:

- Diplomë për arsimin e duhur origjinal apo e notariuar
- Certifikata e shtetësisë

Dokumentet e arritura pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

SHF "Todor Janev"  
Drejtor  
Violeta Spirkovska



# “XHAKA PO LUAN PA TRU DHE I PA KONCENTRUAR”



Ish-lojtari i Arsenalit beson se kosovari rrezikon që shumë shpejt të startojë pasi që të tjerët janë duke konkurruar për pozitën e tij

vjeçari pritet ta humbet këtë vend, me Lucas Torreiran që e sheh shpejt para tij në formacionin e parë. “Xhaka vazhdimisht e humbet topin dhe atë shumë në këtë sistemin e ri pasi që luan më shumë me mbrojtjen. Ai ka nevojë që të lëvizë më shumë se mundet”, ka thënë ish mesfushori i Arsenalit për The Sun.

“Por, ai mund të mësojë si ta përdorë topin në këto zona. Nëse krahasohet me Matteo Guendouzi, i cili ka impresionuar këto ndeshje, ai është shumë më pak energjik apo i lëvizshëm. Nëse ai nuk e bën punën e tij, Emery shpejt do ta lërë në bankë, ashtu sikurse bëri që në pjesën e parë kundër Chelsea. Me Lucas Torreira, i cili mendoj që herët apo vonë do të startojë, Xhaka do të mbetet në bankë tek Arsenalit.”

Roli i Granit Xhakës në Arsenal është vënë në pikëpyetje nga Ray Parlour, me kosovarin që ai e ka konsideruar se “e humbet shpesh topin” dhe ka mungesë gatishmërie për lojë. Unai Emery po kërkon nga Arsenalit që të jenë më të pakalueshëm në

mbrojtje dhe qendër por ata në dy ndeshje kanë pësuar pesë gola. Xhaka konsiderohet mburojë para katër mbrojtësve, përderisa ai duhet të bëjë edhe lidhshmëri në mes të mbrojtjes dhe sulmit.

Parlour, megjithatë, ka treguar se 25

**Klop “i dashuruar” me Shaqirin: Në fillim dyshuat, por ai është fantastik!**



Transferimi i Xherdan Shaqirit nga Stoke City tek Liverpool këtë verë ishte disi surprizë me kosovarin e Zvicrës që ishte blerja më e lirë e ekipit të drejtuar nga Jurgen Klop. Siç duket ka qenë vetë tekniku gjerman ai që e ka dashur Shaqirin në skuadër dhe pavarësisht kritikave të shumta, edhe nga legjenda Gary Neville, ai vazhdon ta mbrojë Shaqirin dhe të mos e fshehtë simpatinë për të.

Në daljen e fundit për shtyp ai ka marrë si shembull Shaqirin për t'i provuar gazetarëve se në futbollin anglez nënvlerësohen lojtarët që blihen lirë dhe të gjithë duan shpenzime të çmendura. “Nuk mendoj se kultura gjermane e futbollit do të toleronte transferimet prej 150 milionë eurosh. Ata nuk duan asgjë më shumë se një transferim të lirë. Pamja në Angli është ndryshe. Nëse një lojtar nuk kushton shtrënjtë, ekziston dyshimi se ai mund të jetë i padobishëm. Për shembull, kishte shumë pyetje (në Angli) për interesin tonë për Xherdan Shaqirin”, tha ai për SPORT1.

Në vijim Klop theksoi se pavarësisht vlerës së ulët në merkato, Shaqiri është një futbollist i talentuar dhe mund të bëjë mirë për ekipin. “Ne kemi paguar 13 milionë funte për atë pasi ai u zhvendos nga Stoke. Por ai është një lojtar fantastik dhe tani të gjithë në klub e duan atë. Në krahasim me Gjermaninë, është me të vërtetë ndryshe. Më kujtohet pak vite më parë, tema e të gjithëve në Gjermani ishte shuma e parave, rreth 100 milionë euro, që Bayern Munchen thuhej të kishte në rezervë. Këto ditë ju nuk do të merrni edhe një gjysmë Neymar për këtë vlerë”, theksoi Klop.

## Lajm i keq për Kosovën

Mesfushori kosovar, Valon Berisha rrezikon seriozisht që të mbetet jashtë grumbullimit të përfaqësueses për dy ndeshjet e shtatorit. Reprerentuesi kosovar i cili gjatë kësaj vere u transferua te Lazio nga Salzburgu, nuk e filloi aventurën e tij në Itali në mënyrën më të mirë të mundshme, duke pësuar një lëndim para vetëm pak javësh. Përfaqësuesja e Kosovës më 7 shtator do të takohet me Azerbajxhanin në Baku, kurse tri ditë më vonë i pret në shtëpi Ishujt Faroe, ndeshje këto që do të zhvillohen në kuadër të Ligës së Kombeve. Futbollisti i Lazios momentalisht është duke vuajtur nga një lëndim dhe për këtë arsye nuk është grum-



bulluar për ndeshjen e së shtunës ndaj Juventusit. Kjo gjë ka bërë që paraqitje e tij për ndeshjet e Kosovës në shtator të vihen

në dyshim. Përgjedhësi i Kosovës, Bernard Challandes pritet ta publikojë listën e lojtarëve të ftuar gjatë javës së ardhshme.



## Shkëndija humbi, por mbetet në lojë

Shkëndija e ka humbur ndeshjen e parë të fazës së “Play-Offit” të Europa Leagues pasi është mposhtur nga Rosenborgu në Trondheim me rezultat 3:1. Kuqezinjtë e kanë gjetur shpejt veten në disavantazh prej dy golash, por në pjesën e dytë janë treguar më të vëmendshëm se e kanë shënuar një gol, i cili i lë në lojë për ta siguruar kualifikimin historik në fazën e grupeve të Ligës së Evropës.

Norvegjezët i kanë shënuar dy gola në 15 minutat e parë. Fillimisht ka realizuar Issam Jebali në minutën e 11-të, kurse sulmuesi i njohur Nicklas Bendtner e shtoi epërsinë e vedësve në minutën e

15-të. Dhe, Jonathan Levi shënoi për 3:0 në minutën e 44-t për ta mbyllur pjesën e parë me epërsi të thellë.

Mirëpo, djelmoshat e Qatip Osmanit bënë lojë më të mirë në pjesën e dytë, në të cilën krijuan raste dhe shënuan një herë me Stenho Junior në minutën e 76-të dhe ky gol i mban gjallë shpresat e ekipit tetovar që ta prek fazën e grupeve, të cilën e kishte shijuar vetëm një ekip shqiptar deri tash – Skënderbeu i Korçës. Sigurisht, Shkëndijën e pret një punë mjaft e vështirë për ta përmbysur rezultatin pas një jave në Shkup, ku i nevojitet një fitore prej 2:0, por Kuqe-

zinjtë do ta kërkojnë mrekullinë të përkrahut nga tifozët e tyre benikë, “Ballistët”, por edhe tifozët tjerë shqiptarë.

Shkëndija e nisi këtë sezon në Ligën e Kampionëve, ku mori pjesë për herë të dytë në histori, për ta eliminuar fillimisht ekipin uellsian The New Saints, ndërsa në rrethin e dytë kualifikues ishte më e mirë se skuadra e njohur moldave, Sheriff Tiraspol. Kurse, në fazën e tretë të Championsit u eliminua nga ekipi austriak, Red Bull Salzburg për të vazhduar në kompeticionin e dytë më të rëndësishëm në Evropë, ku luajti me mjaft sukses viteve të fundit.



ARSENAL		
MAX SPEED RAMP U		
MAX SPEED		
PLAYER	MAX SPEED	% MAX SPEED
Henrik Larsson	10.01	97%
Hector Bellerin	9.63	94%
Alexander Lacazette	9.59	94%
Alexander Isak	9.56	94%
Sokolos Kallay	9.48	93%
Rob Holding	9.41	92%
Daniel Welbeck	9.37	92%
Mesut Ozil	9.35	92%
Alex Lacazette	9.30	91%
Karl Henry	9.18	90%
Henrik Larsson	9.14	89%
Stephan Lichtsteiner	9.00	88%
Mathieu Flamini	8.90	87%
Granit Zhaka	8.90	87%
Mathieu Flamini	8.97	88%
Michael Krohn-Byrh	8.76	86%
Lucas Torreira	8.73	86%

### Kush janë "raketat" dhe "breshkat" e Arsenalit

Arsenali e ka nisur në mënyrën më të keqe të mundshme Premier Leaguën, teksa ka marrë dy humbje në dy takimet e para, ndonëse përballë ka pasur skuadra si Manchester City dhe Chelsea. Pierre Emienike Aubameyang ka përfunduar në qendër të kritikave, pasi ka shpërdoruar shumë mundësi shënimi, veçanërisht ndaj Chelsea, ku skuadra e Unay Emery humbi me vetëm një gol diferencë, 3-2. Tekniku spanjoll kërkon që skuadra të rikthehet menjëherë te fitoret dhe dje ka realizuar edhe një test shpejtësie të futbollistëve të tij, për të parë se si është gjendja e tyre fizike. Rezultatet e testeve janë publikuar në Instagram nga ai që ishte edhe më i shpejti i skuadrës, Aubameyang, i cili ka dashur t'u japë edhe një përgjigje kritikëve të tij, duke treguar se gëzon një top formë. Ish sulmuesi i Borussia Dortmund regjistroi rezultatin më të mirë, duke u konfirmuar si lojtari më i shpejti i "topçinjve", ndërsa "breshka" e skuadrës ishte Lucas Torreira. Mesfushori uruguian i ardhur këtë verë nga Sampdoria, nuk ka shpejtësinë në të vrapuar armën e tij më të fortë, por shpejtësinë e veprimit dhe të qarkullimit të topit, cilësi për të cilat edhe londinezët shpenzuan rreth 35 milionë euro.

# NJË AVION ME QIRA PËR PAKËNAQËSITË NDAJ DREJTUESVE TË MAN. UNITED

Një parullë që ngrihet në nivelin e "shpalljes së luftës" kundër drejtuesve amerikanë të klubit britanik, veçanërisht ndaj zv.presidentit ekzekutiv Ed Woodward, i cili konsiderohet si përgjegjësi kryesor i merkatos "amatore"



tuar një avion, i cili me rastin e ndeshjes në transfertë me Burnley, më 2 shtator, do të fluturojë mbi stadium me një parullë të çuditshme pakënaqësie. Në të shkruhet "Ed Out - LUGH", që nënkupton "Të largohet Ed - Dashurojmë United, urrejmë Glazers".

Një parullë që ngrihet në nivelin e "shpalljes së luftës" kundër drejtuesve amerikanë të klubit britanik, veçanërisht ndaj zv.presidentit ekzekutiv Ed Woodward, i cili konsiderohet si përgjegjësi kryesor i merkatos "amatore". Esikur të mos mjaftonte kjo, edhe Pogba duket se ka shprehur pakënaqësitë e tij, duke i kërkuar klubit ta nxjerrin në shitje. Një lamtumirë që do të përkeqësonte edhe më shumë raportet mes drejtuesve, trajnerit dhe tifozëve.

Për Manchester United nuk ka paqe! Pakënaqësitë e shprehura nga trajneri Jose Mourinho përkundërt një merkatoje të

varfër dhe shumë poshtë pritshmërive të tij, tashmë po shkakton pasoja negative në të gjithë ambientin e "djajve të kuq",

veçanërisht mes tifozëve. Sipas asaj që publikojnë tabloidët britanikë, mbështetësit më fanatikë të Manchester United kanë preno-

## Mick Schumacher dëshiron të bëjë hapa të mëdhenj si babai i tij



I biri i Michael Schumacherit ka thënë se ambicia e tij është të shkojë hapave të babait të tij dhe të fitojë titullin në serinë e garave

Formula 1. Mick Schumacher, 19-vjeçar, ishte në pistë skijimi me babanë e tij kur legjenda e Formula 1 pësoi një aksident katastrofal që e la në komë. Gjendja e tij aktuale nuk është bërë e ditur nga familja. "Ai ishte idhulli im dhe unë jam duke ndjekur çdo gjë që ka bërë ai dhe jam shumë i lumtur me këtë", ka thënë Mick në një intervistë për "BBC". Tinejxheri ka bërë hapa para në botën e motosporteve me fitoren e tij të parë në garën e Formula 3 në Spa të Belgjikës muajin e kaluar.

## Refuzoi Shqipërinë se ndihej grek, ja çfarë i ka ndodhur tani 20-vjeçarit

Vetëm pak muaj më parë, talenti shqiptar, Enea Mihaj u largua zyrtarisht nga kombëtarja e Shqipërisë, duke zgjedhur të përfaqësojë Greqinë. Vendimi i tij erdhi pasi ai e ndjente veten grek duke qenë se kishte lindur në Greqi. Me shpresën se me grekët do të arrijë në nivele më të larta, Mihaj ka marrë "surprizën" e parë nga trajneri i Greqisë U21. Ky i fundit, nuk e ka grumbulluar fare për ndeshjet miqësore skuadra do të luajë në fillim të shtatorit. Padyshim që zhgënjimi për Mihajn do të jetë



i madh duke qenë se planet në mendjen e tij ishin të mëdha. Po tani ç'do bëjë?

Publicitet

Në bazë të nenit 176 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 82/18), Fakulteti matematiko-naturor në Shkup, shpall

### KONKURS për zgjedhje të titujve mësimit-shkencor

#### INSTITUTI PËR GJEOGRAFI

1. Zgjedhje të një mësimeve në të gjitha titujt mësimit-shkencor për grupin e lëndëve nga sferat mësimore-shkencore: *gjeografia dhe sferat tjera specifike* (hidrologjia, limnologjia, resurset ujore në funksion të turizmit, gjeografia rurale dhe standardizimi dhe përshtatja e të dhënave) dhe *klimatologjia*. Afati për zgjedhje është për kohë prej pesë vjet.

Kushtet: Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 82/18) dhe akteve të tjera të Universitetit dhe Fakultetit.

Konkursi është i hapur 8 ditë nga dita e publikimit. Shuma në të holla e pagesës fillestare të mësimeve është 31.050,00 denarë në neto shumë. Pagesa fillestare mund të jetë e ndryshueshme.

Orari i punës është caktuar në pajtim me kalendarin studentor dhe orarin e orëve të Fakultetit. Procedura pas konkursit mund të zgjatë më së shumti gjashtë muaj.

Në Arkivin e Fakultetit kandidatët duhet të dorëzojnë: fletëparaqitje për pjesëmarrje në konkurs, dokumentet e nevojshme për shkallën e arsimit (një ekzemplar origjinal dhe tre kopje të vërtetuara në noter), vërtetim për njohje të gjuhës së huaj (një katër kopje), biografi të shkurtër (një katër kopje), formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titujt mësimit-shkencor, shkencore dhe tituj mësimit-profesional (merret në fakultet) dhe certifikatë të shtetësisë (një katër kopje).

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë procesit të vendimmarrjes. Për informata të tjera në lidhje me Konkursin kandidatët mund të drejtohen në Sekretariatit e Fakultetit matematiko-naturor në Shkup.

Dokumentet të dorëzohen në ndërtesën e Fakultetit Matematiko-Naturor në Shkup, rr "Arhimedova" nr. 3, 1000 Shkup.

UNIVERSITETI "SHËN KIRILI DHE METODI" - SHKUP  
FAKULTETI MATEMATIKO-NATYROR - SHKUP

## Wilshere si Pirlo



Trajneri i West Hamit, Manuel Pellegrini e ka krahasuar mesfushorin e tij Jack Wilshere me legjendën italiane Andrea Pirlo. Wilshere, i cili kaloi te West Hami gjatë verës nga Arsenali, do të rikthehet të luajë ndaj ish-klubit të tij të dielën. Reprzentuesi anglez ishte vlerësuar shumë në "Emirates", por lëndimet ia shkatërruan atij mundësinë për

të pasur vazhdimësi te Arsenal. "Shumë prej jush e kujtoni Juventusin para katër apo pesë vitesh, ata luanin me vetëm një mesfushor prapa. Ishte Pirlo. Dhe Pirlo është njësoj si Jacku. Ai kishte karakteristikat e njëjta si Jacku", deklaroi Pellegrini. "Unë mendoj se Jack Wilshere duhet të luajë si Jack Wilshere. Ai nuk është një mesfushor mbrojtës për të mbajtur vijën", shtoi ish-trajneri i Real Madridit. "Ju duhet ta lejoni atë që të luajë vetëm, të ketë momentin e tij, ta pranojë topin sepse ai mund t'i realizojë gjërat. Unë mendoj se të gjithë e lënduan Jack Wilsheren jo vetëm për një ndeshje sepse nëse ai do të mund të luante normalisht pa lëndime, ai ishte një lojtar që e bënte gjithmonë diferencën sepse ai është një lojtar i veçantë", u shpreh ai.





## Dortmund afër blerjes të Alcacer

Cjiganti gjerman synon blerjen e sulmuesit spanjoll, që nuk e ka gjetur veten në Camp Nou, para mbylljes të këtij afati kalimtar. Borussia Dortmund është afër transferimit të sulmuesit të Barcelona, Paco Alcacer, shkruajnë mediat spanjolle. Skuadra gjermane është e interesuar që fillimisht ta huazojë sulmuesin, por që ta ketë edhe mundësinë e blerjes. Edhe Lionel Messi i ka dhënë dritën e gjelbër Barcelonës për largimin e Alcacer, që në 50 paraqitje dhe 15 gola në të gjitha garat.

# "BAD BOYS" TË FUTBOLLIT, LOJTARËT MË TË KËQIJ NË EUROPE



Bullgari madje ka marrë nofkën 'Thika' për frikën që iu ngjallte kundërshtarëve jo vetëm gjatë aksioneve. Që në ndeshjet e para me Barcelonën, ai u pezullua për 6 muaj pasi goditi arbitrin e ndeshjes

Falë trajnerëve të huaj që preferojnë më së shumti lojën teknike se sa atë fizike në Premier League po bëhet dallimi edhe mes futbollistëve. E përditshmja 'Daily Mail' ka bërë madje me këtë rast edhe

renditjen e futbollistëve më të këqij të Europës. Sipas saj, në vend të parë duhet të renditej Hristo Stoichkov. Bullgari madje ka marrë nofkën 'Thika' për frikën që iu ngjallte kundërshtarëve jo vetëm gjatë aksioneve. Që në ndeshjet e para me Barcelonën, ai u pezullua për 6 muaj pasi goditi arbitrin e ndeshjes.

Në vend të dytë Andoni Goikoetxea, "kasapi" i Bilbaos për shkak të ndërhyrjes brutale ndaj Maradonës duke i thyer edhe këmbën. Gennaro Gattuso e kishite treguar herët temperamentin e tij. Kur luante për Sion në Zvicër, i mori kartonin e verdhë arbitrit për

të ndëshkuar një lojtar kundërshtar, ndërsa në 2011 kapi për fyti trajnerin e Tottenham gjatë një ndeshje të Champions League. Nëse vitet e fundit Arsenali ka një reputacion të mirë, në fillimet e Arsene Wenger konsiderohej si një prej skuadrave më të pista. Për këtë kontribuoi fuqishëm Patric Viera. Nuk janë të pakta rastet e përplasjeve të tij fizike. 1.95 i gjatë, një "monstër" i vërtetë është quajtur Zlatan Ibrahimovic. Brez i zi në taekwondo dhe me temperament ballkanas ka një listë të gjatë viktimash. Në 20 lojtarët më të këqij nuk mungojnë Marco Materazzi, Eric Cantona apo edhe Pepe.



## Largimi nga Reali, vendimi më i mirë në karrierë

Arjen Robben ka insistuar se zgjedhja e tij për të lëvizur nga Real Madridi te Bayern Muencheni ka qenë vendimi më i mirë që ka marrë në karrierë. Robben, 34-vjeçar, ka vazhduar kontratën me Bayernin në maj të këtij viti edhe për një stinor, duke e lënë atë një dekadë në klubin gjerman. Robben iu bashkua Bayernit nga Reali në vitin 2009 dhe ka fituar shtatë tituj të Bundesligës, katër herë Kupën e Gjermanisë dhe Ligën e Kampioneve.

## Dembele mbetet tek Barça



Ylli i Barcelona është i interesuar të mbetet në Camp Nou, ndërsa pranon se do të donte që të luante krah bashkëkombasit të tij në të ardhmen. Ousmane Dembele është i vendosur të mbetet tek Barcelona, duke përjashtuar kesh-

tu mundësinë e kalimit tek Arsenal, ndërsa pranon se do që të luajë krah Paul Pogba. Pasi ka kaluar fazën testuese në Camp Nou, si rrjedhojë e një transferimi goxha të shtrenjtë verë e shkuar, mediat kanë raportuar se ai mund të largohet nga Camp Nou këtë verë. Emirates Stadium që përmendur si destinacion i mundshëm për njeriun shërbimet e të cilit Barcelona i bleu për 105 milionë euro vitin e shkuar. Por Dembele është i vendosur të mbetet në Camp Nou, megjithëse e di se do të ketë konkurrencë të fortë për pozitë titullari, pas transferimit të Arthur dhe Malcom.

## Skriniar gëzon zikaltrit

Mbrojtësi i Inter, Milan Skriniar ka thënë se nuk mendon të largohet nga Guiseppe Meazza gjatë afatit kalimtar të verës. Ai kërkohet nga klube të mëdha europiane si Barcelona dhe Manchester United, të cilat janë synojnë të sigurojnë shërbimet e lojtarit. Por Skriniar, që ka regjistruar paraqitje fantastike me Inter edicionin e shkuar, ka deklaruar se nuk është fare i interesuar të largohet nga Inter. "Nuk shqetësohem për fjalët e transferimeve. Objektivi ka qenë që të shkojmë në Ligën e Kampioneve



me Inter". "Jam i lumtur në Milano, dhe nuk kam menduar të largohem nga Italia, nuk e kam diskutuar të ardhmen".

## Real bën gati ofertën për sulmuesin e Spanjës

Cjiganti spanjoll është i interesuar në transferimin e një sulmuesi para mbylljes së afatit kalimtar, ndaj është i gatshëm ta aktivizojë klauzolën e largimit të spanjollit

Real Madrid është gati t'i paguajë 40 milionë euro për transferimin e Iago Aspas gjatë këtij afati kalimtar. Skuadra spanjolle është e interesuar të transferojë një sulmues këtë verë dhe asi i Celta Vigo shihet si mundësi e mirë. Për më tepër, tekniku i ri i Të Bardhëve, Julen Lopetegui, ka punuar me Aspas



tek Spanja dhe i njeher mirë cilësitë e lojtarit. Skuadra kampione e Europës nuk ka bërë ndonjë transferim të madh këtë afat kalimtar, megjithë largimin e Cristiano Ronaldo drejt Juventus.

## Maksimovic dhe Ospina mund të startojnë kundër Milanit

Carlo Ancelotti po planifikon që të bëjë disa ndryshime për skuadrën e Napolit kundër Milanit, derisa ai mund të startojë me David Ospinan dhe Nikola Maksimovicin. Ndeshja do të zhvillohet të shtunën në ora 18:30 në San Paolo stadium. Napoli e filloi sezonin më fitore kundër Lazios 2-1, por Ancelotti është duke u përgatitur për të bërë disa ndryshime. Më i madhi mund të jetë ish portieri i Arsenalit Ospina, të cilit do ti jep debutim para Oresti Karnezis. Një tjetër befasi, sipas Sky Sport Italia, Maksimovic pritet të zëvendësoi Raul Albiolin në qendër të mbrojtjes. Napoli pagoi 25 milionë euro për ta sjell Maksimovicin nga Torino më 2016, por trajneri Maurizio Sarri nuk e preferonte fare serbin.







## Verratti është "zhdukur", alarmohet edhe Mancini i Italisë

Prania e Marco Verrattit në fushë të ofron garanci për një lojë të bukur, por pikërisht praninë e tij e kemi parë shumë rrallë nga sa mund ta parashikonim deri më tani. Një aktivizim në miqësoren ndaj Atletico's së Madridit, të fituar 3-2 më 30 korrik, si dhe 74 minuta të një niveli të lartë në Superkupën e Francës, të fituar gjithashtu 4-0 përballë Monacos, më 4 gusht janë shumë pak. Këto dy aktivizime dhanë sinjalin sikur nisja e sezonit të ri të kampionatit francez do ta shihte protagonist mesfushorin italian, por ai nuk është grumbulluar nga trajneri Thomas Tuchel i PSG-së, i cili ndoshta nuk preferon të ndër marrë risqe me Verrattin, duke qenë se gjatë 3 sezoneve të fundit ai ka munguar në 53 ndeshje gjithsej për shkaqe dëmtimesh, të paktën siç përllorarit francezja "Le Parisien". Gjatë këtij viti 2018, Verratti ka zhvilluar vetëm 18 ndeshje, përfshi këtu edhe një me përfaqësuesen axurre të Italisë. "Nëse nuk do të ishte për ndërhyrjen kirurgjikale, -shpjegon trajneri gjerman, -do ta kisha aktivizuar". Verratti u operua më 3 maj të këtij viti dhe, sipas Tuchel, ende nuk e ka marrë veten totalisht, ndaj dhe stërvitet i diferencuar nga pjesa tjetër e grupit. Objektivi i klubit është që ai të rikthehet në formën optimale nga mesi i shtatorit, kur do të luhen edhe sfidat e para europiane. Megjithatë, kjo mund të mos mjaftojë për teknikun e Italisë, Roberto Mancini, i cili përgatitet për impenjimet e ardhshme në Ligën e Kombeve.

# ME RONALDON FITOJNË TË GJITHË, PARMA SHET BILETAT PËR NJË ORË

Pavarësisht rritjes së çmimit, tifozët kanë blerë të gjitha biletat e vëna në dispozicion brenda një ore, ndërsa nesër klubi do të nxjerrë në shitje edhe rreth 2000 bileta të tjera në anësore, që gjithashtu pritet të mbarohen brenda pak minutave, për të mbushur plot e përplot stadiumin



Parma u rikthye në Serinë A këtë sezon, pasi bëri një kapërcim të jashtëzakonshëm, ku brenda 3 vitesh u ringrit nga Seria D, në ligën elitare italiane. Skuadra emiliane debutoi të dielën në mbrëmje në "Tardini", ku priti Udinesen dhe i shkoi shumë pranë triumfit, por shpërdoroi avantazhin 2-0, duke u dhënë mundësi friulianëve të barazojnë dhe të marrin një pikë.

Këtë javë Parma do të luajë në transfertë ndaj Spalit, një skuadër me të cilën do të duetjohet direkt për të mbijetuar në Serinë A, por mendja e emilianëve ka është që tani të ndeshja e 1 Shtatorit në mbrëmje. Në stadiumin "Tardini" do të zbrisë Juventus, bashkë me Cristiano Ronaldon, ndërsa njoftimet nga klubi thonë se janë shitur të gjitha biletat e nxjerra në shitje deri tani.

Pavarësisht rritjes së çmimit, tifozët kanë blerë të gjitha biletat e vëna në dispozicion brenda një ore, ndërsa nesër klubi do të nxjerrë në shitje edhe rreth 2000 bileta të tjera në anësore, që gjithashtu pritet të mbarohen brenda pak minutave, për të mbushur plot e përplot stadiumin. Ky interes është i ngjashëm me atë të "Bentegodit" në javën e kaluar, ku Chievo dyfishoi çmimet e biletave

dhe arriti të mbushë plot stadiumin, në sfidën ku CR7 bëri edhe debutimin zyrtar në Serinë A.

Natyrisht që Juventus ishte skuadra që pagoi shifra stratosferike për të sjellë Ronaldon në Torino, por nga ky transferim duket se po përfitojnë të gjitha klubet e Serisë A, pasi përveç biletave të shitura, është rritur ndjeshëm edhe shikueshmëria e interesi i sponsorëve për kampionatin italian.

## Kam ambiciet e mia, dua titullin me Napolin

Merkatoja e Serisë A u mbyll të premten e kaluar, ndërsa mes skuadrave të mëdha, Napoli ishte më pak aktiv, duke humbur një organizator si Jorginho dhe duke afruar lojtarë pa eksperiencë në Serinë A. Gjithsesi blerja e vërtetë e napolitanëve ishte emërimi i Carlo Ancelotti në stol, pasi me largimin e Sarrit, De Laurentiis nuk do të mund të kishte bërë zgjedhje më optimale. Pavarësisht mungesës së protagonizmit në merkato, Carlo Ancelotti ka theksuar se ka ardhur plot ambicie në krye të pankinës së Napolit dhe se do të



garojë bashkë me skuadrën, për të sjellë titullin e munguar prej vite-

sh. "Synimi im është të çoj skuadrën në gradën më të lartë të kam-

pionatit. Kam gjetur shumë kualitet te kjo skuadër, që për arsye të ndryshme nuk ia ka dalë të fitojë titullin, por i ka shkuar shumë pranë. Gjithsesi, shpresoj që ky kualitet, duke i shtuar edhe eksperiencën time, të sjellë titullin në qytetin e Napolit", deklaroi Don Carlo. Ancelotti u largua nga Italia në verën e 2009-ës, për të nisur një tur të gjatë në Europë, duke filluar nga Chelsea dhe për të vijuar më pas me PSG-në, Realin e Madridit dhe Bayernin e Mynihut, praktikisht skuadrat më të mira të ligave europiane.

## Zbulohet oferta stratosferike për blerjen e Liverpoolit

Suksesi i Liverpoolit nuk po kalon pa u vënë re edhe nëpër botë dhe në fakt së fundi ka pasur edhe një ofertë për blerjen e klubit. Nuk bëhet fjalë për një ofertë dosido, pasi mund të ishte blerja më e shtrënjtë e një klubi në histori. Oferta erdhi nga sheiku arab Khaled Bin Zayed Al Nahyan, i cili është gjithashtu kushëriri i presidentit të Manchester City, Mansur bin Zayd al Nahyan. Oferta flitet të jetë

bërë në fund të vitit 2017, e mendohet të ketë kaluar shifrën e 2 miliardë eurove, një numër që nuk është arritur asnjëherë për ndryshimin e pronësisë së një skuadre. Khaled, pavarësisht se flitet të jetë një emër me shumë rëndësi në familje e rajonin e Lindjes së Mesme, flitet se nuk ka të njëjtën fuqi ekonomike si Mansour. Gjithsesi, shoqëria amerikane Fenway Sports Group, e cila ka në zotërim ekipin

anglez, ka refuzuar menjëherë ofertën, dhe e ka bërë të qartë që do të pranonte vetëm një ortak në minorancë. Reds kanë filluar në mënyrën më të mirë sezonin e ri, duke fituar dy ndeshjet e para në kampionat përkatësisht 4-0 me West Ham në Anfield Road dhe 0-2 kundër Crystal Palace. Ndeshja e radhës për ta do të jetë në shtëpi ku do të ketë kundërshtar ekipin e Brighton.





**DASHI** 21. mars - 20. prill

Ka të ngjarë të përballemi me disa kritika për shkak të zakonit tuaj për t'i thënë gjërat në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ka ardhur koha për të rivlerësuar pikat e forta dhe planet tuaja për të ardhmen.

**DEMI** 21. prill - 21. maj

Mos e neglizhoni jetën tuaj shoqërore. Kaloni më shumë kohë me miqtë, të cilët do t'ju bëjnë të ndihejni optimist. Një raport dashurie duket i acaruar, por kjo gjë nuk do të zgjasë shumë.

**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Do të jeni shumë të pambrojtur emocionalisht, prandaj qëndroni larg situatave në të cilat keni gjasa të lëndoheni. Investimet e parave në disa projekte të pa-sigurta duhet të shmangen sot. Jini të kujdesshëm ndaj miqve.

**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Sot besimi juaj do të rritet dhe përparimi është i sigurt. Vështirësitë financiare mund të çojnë në kritika dhe argumente. Anëtarët e familjes do të mbajnë një vend të veçantë në jetën tuaj.

**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Mundohuni të dilni nga zyra juaj herët për më shumë rekreacion dhe frymëzim. Problemet financiare rrënojnë aftësinë tuaj për të menduar në mënyrë konstruktive. Mos harroni të falni nëse përballemi me ndonjë padrejtësi.

**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Argëtimi i sotëm duhet të përfshijë aktivitete sportive veçanërisht në natyrë. Një udhëtim do të jetë i dobishëm, por i shtrenjtë. Ju mund të kaloni një mbrëmje vërtet të mrekullueshme me bashkëshortin tuaj sot.

**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Jo të gjithë mund të mendojnë si ju. Mësoni të pranoni edhe opinionet ndryshe sepse mund të marrësh leksione të rëndësishme prej tyre. Mungesa e partnerit në jetën tuaj ju bën shumë nervoz.

**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Të qenit i drejtpërdrejtë jo gjithmonë është diçka pozitive. Përdorni pak diplomaci kur komunikoni me të tjerët veçanërisht me njerëz sapo i keni njohur. Në dashuri, diçka pozitive duket në horizont.

**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Motivoni veten që të jeni më optimist. Kjo rrit besimin dhe fleksibilitetin, por në të njëjtën kohë ju përgatit për të kapërcyer situata të vështira. Mungesa e dashurisë mund të ndihet sot.

**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar


Duhet të shmangni çështjet për të cilat nuk keni informacion dhe që mund të shkaktojnë argumente me njerëzit e dashur. Bëni një surprizë ndaj partnerit tuaj, sepse do të vlerësohet shumë.

**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Dikush mund të përpiket t'ju zemërojë vetëm për të nxjerrë në pah karakterin tuaj nervoz. Mos bini pre e këtij provokimi. Një ditë e dobishme për financat. Nëse keni bërë një investim, ai do të shpërblehet.

**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Kolegët do ju ofrojnë mbështetje të madhe dhe aleancat e reja janë mjaft të mundshme në vendin e punës. Këshilloheni që t'i kushtoni më shumë kohë partnerit tuaj. Financat parashikohen të mira.

	AKTORI AMERIKAN NGA FOTO	ZAKONET	FATURA, HESAPI	QË MBËSHITETET NË ANALIZËN	NË KËTË KOHË, TASH						
MOTRAT E BABAIT	◯										
KËNGËTARJA LUIZA ÇIKONE	◯										
▶	◯										
ISH PRESIDENTI AMERIKAN, RONALD	◯										
SHTET NË EVROPË (pashq.)	◯										
VARG, SËRË	◯				FLUTURUES I PARË (mit.)						
PEZMATIMI I VESHIT	◯										
NETO	◯	LUMË NË INDI									
		PANDERSH-MËRI									
NOTË MUZIK, RËNIA NË GJUMË TË THELLË (mjek.)	◯		POSEDON NGJYRA E KUQE QË PËR-FTOHET NGA ANTRACENI			AJNSHTAJN-IUM	PJESA MË E IMËT E MATERJES (sh. pashq.)	AKTORI AMERIKAN, KUPER	AKTORJA AMERIKANE, SAMS	NORVEGJIA, PORTUGALIA	PENGOHET MBARVAJTJA E NJË PUNE NË MËNURË TË MBULUAR
▶	◯			MATERJE KIMIKE PËR INDIKACION NË TJETRËN OSMANE							
ROLETË PËR TË MBYLLUR DYERT E DYQANEVE	◯					MAKINA E STAMPIMIT HYJNESHË GREKE, E BIJA E ZEUSIT					
BURIM NDRIÇIMI (shq.)	◯					MJETI PËR MATJEN E KOHËS SHKRONJË GREKE				BOR VIJA NDARËSE MIDIS DY SHTETEVE	
SËMUNDJE NGA SASIA E MADHE E AZOTIT NË GJAK									KETRIN OKSENBERG		
MARKË KOMPUTERASH									VETI, CILËSI		
E KEQE E MADHE (sh.pashq.)								E TREMB DIKË			
								FILL I HOLLË PREJ METALI (sh.pashq.)			
KRYEQYTETI I SHQIPËRISË								SËMUNDJE NGJITËSE			
								GRUMBULL			
EMËR I HUAJ FEMRE								LLOJ QILIMI			
								LUMË NË ITALI			
AKTORJA, RUSO								QË U PËRKET POLEVE			
								J, K, L, ...?			
AKTORJA, RINA								BËJ LLOGARI			

FJALËKRYQ KLASIK

1	2	3	4	5	6	7	8	9
10				11	12			
13			14		15		16	
		17				18		
19	20			21			22	
23				24	25			
		26			27			
28	29		30				31	
32		33		34		35		
36								37

**HORIZONTALISHT:** 1. Ish sekretari gjeneral i OKB, Kofi; 5. Emal; 10. Mundësitë objektive për të ndodhur diçka; 12. Lamtumirë (it.); 13. Manekinja, Mekferson; 14. Persi; 16. Gj. K.; 17. Mënjanim i rrezikut; 19. Njëra nga nëntë muzat në mit. Greke; 21. Humbje e zërit (gjuh.); 23. Gazetë italiane; 25. Gomari (turq.); 26. Lidhja ndërmjet djalit e vajzës; 28. O. Gj.; 30. Pjesë e ciklit të plotë; 31. U. M.; 32. Pajisje transmetimi; 34. Arterje e zemrës; 36. Jo e shkurtër; 37. Njësia monetare e kinës (pashq.).

**VERTIKALISHT:** 1. E agjenturës; 2. Mbret nga epi hindus Mahabharata; 3. Kampion; 4. Fjalë ose mendime naive (shum.); 6. Bëj manifestim; 7. Adnan Daci; 8. Rregull, kanun; 9. Njeri që kënaqet me marrjen e helmeve dhe drogave narkotike; 11. Numër njëshifror; 15. Përemër vektor; 17. Shkronja e parë e alfabetit arab; 18. Vitet e jetës (shq.); 20. Kyc; 22. Neon; 24. E shenjtë (turq.); 27. Shkrimtari portugez, Hose Maria; 29. Dëgjoj, pranoj; 31. Liman në Japoni; 33. Notë muzikore; 35. Ruten.

ZGJIDHJET: HALLAT, MADONA, REGAN, ITALI, SERI, OTTI, N. AIK, FA, KA, KOMA, REAGENS, ROLO, STAMPA, DRITA, ORA, B. AZOTEMI, KO, ALAMETE, TIT, TIRANA, TIFO, ATINA, TOPARE, POLARE, ITA, LLOGARIT. FJALËKR. KLASIK: ANAN, SMALT, GJASAT, ADIO, EL, IRAN, GJK, N. EVITIM, S, TALL, AFONI, UNITA, ESHEK, R, FEJESA, O, OGJ, TAKT, UM, RELE, AORTA, EGJATE, JUAN.





## Molossia,

## vendi me vetëm shtatë banorë

Shpesh herë dëgjojmë se si planeti është i mbipopulluar dhe çfarë duhet bërë për të zvogëluar problemin. Kup-tohet që këto shqetësime ekzistojnë në vende ku çështja është më e theksuar, gjegjësisht zonat e populluara kryesisht në botën e zhvilluar ose në zhvillim. Por



ka më shumë se 200 vende në botë, të cilat ndoshta nuk keni dëgjuar kurrë për to sepse janë pak të populluara. Këto janë territore që kurrë nuk e dinim se ekzistojnë. Ato kanë një sipërfaqe shumë të

vogël dhe disa prej tyre janë të banuar vetëm nga disa familje. Për shembull, një nga vendet më të vogla - megjithëse nuk njihet nga Kombet e Bashkuara apo ndonjë vend tjetër - në botë është Republika e Molossia. Është një vend shumë i vogël i themeluar nga Kevin Baugh, që ndodhet në Nevada, SHBA. Popullsia e saj përbëhet nga vetë Baugh, familja e tij, tre qen, një mace dhe një lepur. Molossia ka himnin e vet kombëtar, emblemën kombëtare dhe flamurin kombëtar. Ata madje kanë dënimin me vdekje për krimet të rënda. Ai lëshon pasaportat e veta dhe madje ka edhe një program hapësiror. Në maj të vitit 2017, Republika hyri në moshën 40 vjeçare.

## 42 herë bie në radar në të njëjtën rrugë



Austriaku Hajmo Wallner për 42 herë ka rënë në të njëjtin radar në rrugën e njëjtë. Bukëpjekësi nga Frizach, që gje-

ti punë në Klagenfurt, ka vozitur në të njëjtën rrugë për disa javë dhe aty nuk ka parë asnjëherë se është shpejtësia e

limituar prej 30 kilometrave për orë, transmeton KP.

"Nuk e pashë se po kaloj nëpër zonë me atë kufizim. Ishte gjithnjë errët dhe isha shumë i lodhur", shpjegoi ai. Disa javë më vonë, Valner mori një numër dënimesh dhe pret më shumë. Deri më tani, Valner është dashur të paguajë rreth 3,000 euro për gjokat.

Nga autoritetet komunale thonë se është hera e parë që dikush në të njëjtin vend bie 42 herë në radar dhe urdhëruan që shoferi të paguajë 300 euro më pak se sa gjoka e përgjithshme. Për shkak të ndëshkimit, babai i gjashtë fëmijëve duhej të anulonte pushimin e tij në Greqi.

## Tri gabime të përditshme që i bëjmë në dush

Të bësh dush pothuajse çdo ditë duket një gjë mjaft e lehtë: mjafton të hapësh dushin, të futesh në të ndërkohë që uji rrjedh, të lani trupin dhe pastaj të thaheni.

Megjithatë, disa njerëz bëjnë gabime në larjen e trupit, e kjo bën që të kenë një lëkurë të thatë ose thjesht shkaktojnë dëme ndaj saj. Ju listojmë 3 gabime që bëhen nga të gjithë gjatë dushit:

- Bëni dush me ujë të nxehtë për një kohë të gjatë: Një dush me ujë të nxehtë të bën të ndihesh mirë, si shembull kur laheni në mëngjes dhe keni ftohtë. Por nga ky dush nuk ka përfitime. Uji i nxehtë shkakton probleme të tilla si rritjen e manisë së kruajtjes së lëkurës apo dhe iritimin. Dushi me ujë shumë të ftohtë gjithashtu nuk ka përfitime. Kështu që rritni diku në mes dy alternativave, transmeton living.al.

- Nuk hiqni plotësisht shkumën nga trupi juaj: Shpesh, pasi keni mbaruar



larjen dhe shihni që një pjesë e vogël e trupit nuk është shpëlarë mirë nga shkuma, ju thjesht e fshini atë me peshqir. Ky nuk është një veprim i zgjuar. Mosshpëlarja e mirë e trupit zakonisht çon në acarim dhe thatësi të lëkurës, por varet gjithashtu edhe nga lloji i sapunit ose shamponit që përdorni.

- Përdorni peshqir të ashpër: Mënyra se si thaheni është po aq e rëndësishme sa larja. Një fshirje e lehtë me peshqir të butë, është më e mira për lëkurën tuaj. Aplikimi i kremrave hidratues menjëherë pas dushit është i rekomandueshëm pasi pas dushit lëkura juaj është e thatë.

325 - Përfundon Koncili i Nikesë me adoptimin e themelimit të besimit në doktrinën e Trinitetit të Shenjtë.

1499 - Beteja e Sapiencës: Flota turke mund venedikasit.

1580 - Beteja e Alkandaras: Spanja mund Portugalinë.

1609 - Galileo Galileu prezanton teleskopin e tij të parë para anëtarëve të parlamentit venedikas.

1698 - Cari Pjetri i Madh kthehet në Moskë pas udhëtimit të tij nëpër Evropën Perëndimore.

1704 - Beteja e Mallagas: Flota franceze kundër flotës angleze dhe holandeze.

1718 - Qindra francez kolonizatorë arrijnë në Luiziana: Themelohet New Orleans.

1768 - Kapiteni Xhejms Kuk nisët nga Plymouth, Angli në lundrimin e tij të parë nëpër Oqeanin Paqësor.

1912 - Beteja mes nacionaliteteve të ndryshme në Maqedoni.

1940 - Lituania, Latvia dhe Estonia inkorporohen në BRSS.

1941 - Trupat angleze dhe ruse sulmojnë Iranin pro-gjerman.

1988 - Irani dhe Iraku fillojnë bisedimet për përfundimin e luftës tetëvjeçare.

Zemra e njeriut pompon 182 milionë litra gjaku gjatë jetës mesatare.



A E DINI SE...

Një tru i vetëm njerëzor gjeneron më shumë impulse elektrike në një ditë se të gjithë telefonat e botës të kombinuara.

Qeniet njerëzore janë të vetmet gjallesa që flenë në shpinë.



I SHOQI...

Njeri pyet shokun e ngushtë: - Si shkoi mbrëmë tek shtëpia e të dashurës?

- Perfekt. I bëra përshtypje shumë të mirë vjehrrës dhe vjehrrit, kuletërve, hallave dhe tezeve... I vetmi që më shihte shtrembër ishte i shoqi...

KALENDARI HISTORIK 25 GUSHT

A E DINI SE...



BARSOLETA

THËNIA E DITËS



Pyetja nuk është kush do të më lejojë; është kush do të më ndalojë. (Ayn Rand)